

**Raporti zyrtar mbi ngjarjen mbi
"operacionin e spastrimit"**

Nga Kastriot Dervishi

Paralelisht me ngjarjet e ambasadave në Tiranë, u zhvilluan disa ngjarje të tjera në Kavajë. Në qytetin ku lëvizja antikomuniste kishte shtratin e vet të natyrshëm. Demonstrata antikomuniste e 26 marsit 1990 u pasua nga ajo

e 3 korrikut të këtij viti. Për këtë arsye demonstrimi antikomunist në Kavajë, përfshi jehonën edhe në radiot ndërkombëtare, ku më i njohuri ishte ai i "Zërit të Amerikës", u bë shqetësues për regjimit. Në Kavajë u dërguan forca speciale të cilat nisën veprime të...

Rama i jep dorën pa lekë Obamës

Në sajë të një arritjeje të reformave të Sali Berishës, Shqipëria ulet si e barabartë në tryezën e vendeve anëtare të NATO-s dhe këtë herë protokollin e samitit i ka mundësuar Edi Rama të t'i japë dorën presidentit të SHBA-së, pa pasur nevojë të paguajë dollarë apo të hiqet si Gruaja e Bilalit. Fotoja u keqmontua dhe u keqpërdor në Tiranë për interesat e propagandës së kryeministrit, por ajo i shërben publikut për të kujtuar se është e nevojshme thirrja e Edvinit në prokurori dhe sqarimi i burimit të 80 mijë dollarëve

Fotoja me Obamën, Rama kreu krim federal me para droge

**Paloka: Edi Rama është nën
detyrim të bëjë transparencë****Reforma në Drejtësi, PD prezanton
gjashtë hapat për procesin e Vetëingut**Bylykbashi: Formulë konsensuale,
garanton mbajtjen e politikës larg procesit**Salianji në Berat: Qeveria e ka
braktisur totalisht qytetarin,
mbështet grupe të vogla klienteliste**Fermerët e fshatrave Kuç, Çiflig, Arrëz e Banaj në
protestë, janë përmblytur tre herë, asnjë qindarkë
dëmshpërblim nga qeveria**KULTURË**Intervistë me z. Marius Dobresku,
përkthyesin e letërsisë shqipe në Rumani**Duhet investime më të
mëdha për letërsinë shqipe!**

"Fatkeqësisht letërsia shqipe nuk njihet në Rumani. Përveç Ismail Kadarese, si dhe disa poetëve që kanë dalë në shtypin letrar, letërsia shqipe nuk është e njohur. Ka poetë shumë të mirë në Rumani, edhe sot, jo vetëm klasikë..."

**DITA**

Të dhëna të reja nga sevdaja e Edvinit me serbët

**Daçiç i këndon Ramës
për ditëlindje: O dielli im**

Ditëlindja e kryeministrit të Shqipërisë Edi Rama, 4 korriku, ndodhi që të kremtohej gjatë mbajtjes së Samitit të Ballkanit Perëndimor në Paris. Presidenti francez, François Hollande ka shtruar një darkë mikëpritjeje për të gjithë kryeministrat e Ballkanit, që ishin pjesë e samitit në Paris. Në darkën solemne të Samitit, Ivica Daçiç, shef i diplomacisë serbe, i ka bërë një surprizë kryeministrit shqiptar, duke i kënduar një këngë, shkruajnë mediat kosovare...

**POLITIKË**

Skandali/ Rama ka premtuar lirim të Shullazit brenda 4 muajsh, trajtim special në qeli

**Tahiri zhvillon takime periodike në
qelitë e paraburgimit me Milin e Partisë****LAJMI**

**I dyshuari i Rinasit:
Policia tentoi të
më eliminonte,
duan të më
faturonjë grabitjen**

**FORUM**

**Politika e të
ardhmes:
Të hapur dhe të
armatosur**

Nga Fareed Zakaria
(The Washington Post)

**Në Dallas, qëllohen
të paktën
11 policë, 5 të vrarë
- a po
shkon SHBA drejt
luftës civile?**

**Profil/Pjetër Arbnori,
simboli i qëndresës
dhe tolerancës**

Pjetër Arboni do të mbamendet gjatë në kujtesën e gjeneratave, kjo jo vetëm se përfaqësoi njeriun e përkorë, politikanin tolerant por dhe shkrimtarin disident dhe penën thukët të shëmbëllimit të një shpirti sa delikat aq dhe luftarak...

Reforma në Drejtësi, PD prezanton gjashtë hapat për procesin e Vetingut

Bylykbashi: Formulë konsensuale, garanton mbajtjen e politikës larg procesit

Partia Demokratike ka publikuar propozimin e ri për reformën në Drejtësi, duke theksuar edhe gjashtë hapat që do të ndiqen për zgjidhjen e procesit të Vetingut për gjyqtarët dhe prokurorët. Në një takim me gazetarët, Bylykbashi thotë se propozimi i ri i opozitës zgjidh në mënyrë të plotë dhe pa asnjë lloj ngërçi, përzgjedhjen e 12 anëtarëve, të komisionarëve të Vetingut, të cilët janë shkalla e parë e këtij procesi. “Sot jemi përpara jush, ashtu siç premtuam para dy ditësh, për t’u prezantuar propozimin e opozitës për formulën e kompromisit, e cila zgjidh në mënyrë të plotë dhe pa asnjë lloj ngërçi, përzgjedhjen e 12 anëtarëve, të komisionarëve të Vetingut, të cilët janë shkalla e parë e këtij procesi të rëndësishëm të parashikuar për reformën në drejtësi. Sigurisht që kjo është një formulë e aplikueshme me modifikimet e nevojshme edhe për rastet e tjera, për institucionet e tjera. Siç e thashë, është një formulë e cila garanton në mënyrë fare të thjeshtë përmbylljen me sukses të procesit të përzgjedhjes së komisionarëve me hapa të thjeshtë të besueshëm, të pranueshëm nga të gjithë, në përputhje të plotë me paragrafin 88 të opinionit final të Komisionit të Venecias”, tha Bylykbashi.

Hapi i parë/Parashikohet shpallja e vakancave, sigurisht mbi bazën e kriterëve kushtetuese dhe ligjore të përcaktuara dhe të bëra publike dhe transparente për të gjithë. “Në gjykimin tone, për ti dhënë edhe staturën e mjaftueshme procesit, si organ i parë pra që e shpall vakancën dhe mbledh kandidaturat, është Presidenti i Republikës, por në alternativë mund të jetë edhe Avokati i Popullit. Sigurisht ky institucion në bazë të kësaj procedure do të bëjë shpalljen për 12 vakancat dhe do të presë brenda afatit aplikimet e të gjithë personave që mendojnë se

përmbushin kriteret kushtetuese dhe ligjore për të 12 vendet e komisionarëve. Në përfundim të afatit, Presidenti i Republikës apo Avokati i Popullit do të përcjellë dosjet e të gjithë aplikantëve tek Gjykata Kushtetuese. Duhet thënë që Gjykata Kushtetuese është organ që nuk është pjesë e hierarkisë së sistemit gjyqësor, por mbetet një gjykatë me një rol absolutisht madhor në të gjithë sistemin kushtetues, por edhe në propozimet e draftet kushtetuese që kanë qarkulluar deri më sot, edhe Komisioni i Venecias e vlerësoi pozicionin e Gjykatës Kushtetuese në atë pikë që, Gjykata vazhdon dhe ushtron funksionet e pa cenuar në strukturën e saj, me përjashtim të një formule të re e cila do të zbatohet dora dorës sapo të krijohet një vakantë”, tha Bylykbashi.

Hapi i dytë/Bylykbashi u ndal tek zgjedhja e kreut të Gjykatës Kushtetuese që do të përzgjedhë me short një panel prej tre gjyqtarësh kushtetues të cilët do të bëjnë vlerësimin e kandidatëve në përputhje me kriteret kushtetuese dhe ligjore, përfshirë dhe kërkesat për integritetin e kandidatëve. “Në këtë proces, do të verifikohen se si ashtu siç propozohen kandidatura të ndryshme, avokatë, ish-gjyqtarë, ish-prokurorë, apo pedagogë të së drejtës, jo vetëm në përputhje me kriteret, por në përputhje me kërkesat për integritetin, nëse kanë pasuri të pajustificuara apo probleme të tjera. Këtij paneli prej tre gjyqtarësh do t’i bashkëngjitet përfaqësuesi i operacionit ndërkombëtar të monitorimit në rolin e tyre, siç e përcakton qartë Komisioni i Venecias, të rojarit të transparencës. Pra ne, parashikojmë një rol të rëndësishëm për ta, që të garantojnë këtë transparencë. Në këtë kuadër këta do të kenë akses jo vetëm në proces, por tek i



gjithë dokumentacioni i procesit të vlerësimit dhe i këtij pre-vetingu që i bëhet këtyre kandidatëve. Dosjet shqyrtohen individualisht, mbi bazën e këtyre kriterëve, çdo gjë duhet të jetë e matshme dhe duhet të jetë së paku transparente për çdo individ që aplikon. Ky proces duhet të përmbushë plotësisht kriteret, t’i japë mundësinë çdo individ që mendon se i plotëson kriteret. Të vërtetë që ai është individ i përshtatshëm për këtë funksion publik. Pra çdo gjë bëhet me prova dhe me akses, si për aplikantin ashtu edhe për përfaqësuesit e misionit ndërkombëtar të cilët kanë akses në të gjithë dokumentacionin”.

Hapi i tretë/Kur dikush është i pakënaqur me panelin prej 3 gjyqtarësh është e mundur të bëhet një ankim në Gjykatën Kushtetuese, në trupën prej 9 gjyqtarësh, që do të vendosë për pranimin e kësaj kërkesë për rivlerësim të këtij vendimi të panelit. “Mund të qëllonjë që dikush të jetë i pakënaqur me vendimin e panelit tresh, me propozimin tonë parashikohet që të bëhet një ankim para Gjykatës Kushtetuese, para trupës prej 9 anëtarësh tashmë, e cila do të vendosë për pranimin e kësaj kërkesë për rivlerësim të këtij vendimi të paneli tresh, dhe janë gjashtë anëtarë, që janë të papërfshirë, dhe flitet gjithmonë mundësia që edhe vendimi i panelit të rrëzohet ose të pranohet, nëse çdo gjë është e bazuar në ligj dhe në prova. Kjo fazë përmbyll procesin e verifikimit dhe vlerësimit të të gjitha kandidaturave që kanë aplikuar për postin e komisionerit që do të kryejë vetingun. Në këtë moment, kryetari i Gjykatës Kushtetuese mbyll procesin dhe ia dërgon të gjitha kandidaturat e kualifikuara Kuvendit të Shqipërisë”.

Hapi i katërt/ Përzgjedhja e kandidatëve nga Kuvendi. “Në propozimin tone, në përputhje me atë që thuhet në futnotën 16-të, që i korrespondon paragrafit 60 të opinionit final, ne kërkojmë që kjo të bëhet nga një komision parlamentar “ad hoc” me 12 anëtarë (dhe ky është rasti më kompleks sepse në rastet e tjera numri do të jetë më i vogël), ku 6 anëtarë do të jenë nga maxhoranca dhe 6 nga opozita. Siç e dini, tashmë është traditë e konsoliduar e parlamentit që të

ketë komisione të rëndësishme me paritet numri dhe të njëjtën gjë propozon edhe Komisioni i Venecias. Ky komision do të zgjedhë pa debat 12 kandidatura që do ti paraqiten Kuvendit për miratim dhe kjo bëhet duke përcaktuar që çdo anëtar i komisionit “ad hoc” të ketë vetëm një votë dhe të votojnë vetëm për 1 kandidat. Logjikisht në fund të procesit do të dalin 12 kandidatë të përzgjedhur nga komisioni. Në propozimin tonë ky është një moment i rëndësishëm sepse votimi është i fshehtë dhe elektronik. Votimi elektronik bëhet me qëllim për të garantuar që në fund fare të dalin 12 kandidatë. Pra të 12 anëtarët e komisionit do të votojnë të gjithë në të njëjtën kohë. Pra nuk është votim sekuenial, të gjithë votojnë në të njëjtën kohë, të gjithëve u shfaqen në të njëjtën kohë e njëjtë listë kandidatësh dhe nëpërmjet sistemit elektronik bëhet e mundur që një kandidat të votohet vetëm nga një anëtar i komisionit “ad hoc”. Pra një deputet dhe jo nga më shumë se një deputet. Kjo bëhet e mundur nga sistemi elektronik i cili bën të mundur që kur votohet një kandidat nuk mund të votohet nga deputeti tjetër. Kush e zgjedh i pari mund të kalohet tek kandidatura tjetër, sepse të mos harrojmë e gjithë lista prej 20 apo 30 kandidatësh është e barasvlershme. Hapi i radhës ka të bëjë me

Hapi i pestë/Lista i paraqitet për votim Kuvendit në seance plenare. “Çdo kandidat është i certifikuar dhe ka të njëjtën vlerë për sa i përket kriterëve të tyre të përmbushura. Në fund të votimit i cili është mjaft i shpejtë dhe mjaft i thjeshtë siç e shihni, sistemi shfaq listën e kandidatëve të përzgjedhur. Pra është me votë të fshehtë e për rrjedhojë nuk mund të përcaktohet se cili kandidat është votuar nga cili deputet. Lista në këtë moment zyrtarizohet, nuk ka votim tjetër e për rrjedhojë kjo listë bëhet gati për t’ju paraqitur Kuvendit për votim në seance plenare. Kuvendi bën një votim miratues të listës, ose miratues ose refuzues. Pra votimi është në bllok i kësaj liste. Nuk votohen individë. Lista me 12 kandidatë ose miratohet e tëra ose rrëzohet e tëra. Arsyet e rrëzimit mund të jenë të ndryshme por

sigurisht me konsensus paraprak apo me një qëllim pozitiv të të gjitha forcave të përfshira në këtë proces, që të zgjedhin kandidatët më të mirë të mundshëm. Kjo listë me 12 kandidatë i ka të gjitha garantitë që të votohet e miratohet nga Kuvendi. Pra çdo deputet ka një votë, e shpreh votën e tij dhe ne mendojmë që në propozimin tonë ky votim të jetë më shumicë të cilësuar sepse kjo i jep një legjitimitet më të madh listës prej 12 vetësh të miratuar”.

Hapi gjashtë/ Ekziston mundësia që sistemi, ose formula parashikon rastin, kur kjo mund të rrëzohet. “Në këtë rast, të gjithë 12 kandidatët rikthehen tek grupi i kandidatëve të kualifikuar sipas hapit të tretë të bërë nga Gjykata Kushtetuese dhe komisioni rifillon procedurën e përzgjedhjes nga fillimi mes të gjithë kandidaturave. Pra nuk ezaurrohet lista. Mbeten po ato kandidatë dhe një përzgjedhje e re do të prodhohet me atë procedurë që shpjegova më herët, një listë të re prej 12 anëtarësh. Votimi i dytë në propozimin tonë, më pas edhe ai i tretë, kryhet me një maxhorancë që vjen në ulje. Pra mund të niset me 2 të tretat, zbrit me 3 të pestat, pastaj me shumicën absolute. Në gjykimin tonë është një formulë e cila nuk ka bllokim sepse po të jetë e nevojshme mund të ulet maxhoranca deri në atë pikë sa nëse vihet në dyshim një maxhorancë 50 plus 1, atëherë vihet në dyshim maxhoranca në Kuvend e për rrjedhojë nuk ka as qeveri. Gjykojmë që formula është ndërtuar në mënyrë të atillë që nuk ka nevojë për mekanizëm të jashtëm zhblokimi dhe na garanton shumë shpejt e thjeshtë, pa komplikacionet e asaj formule që në kushtet e Shqipërisë është në votën e vetme të trafikueshme që do të krijonte një problem të një karakteri politik shumë të më të rëndë se sa zgjedhja e 12 anëtarëve me integritet”, tha Bylykbashi. Në përfundim Bylykbashi shtoj se kjo është një formulë që garanton një kompromis dhe më tepër se kaq, edhe një funksionim të shpejtë e të thjeshtë. “E ripërsëris, ka më shumë se dy javë që kjo formulë është paraqitur në kanalet e negociimit tek pala tjetër. Deri më sot nuk ka pasur asnjë argument thelbësor për ta kundërshtuar. Për fat të keq maxhoranca vazhdon ta kundërshtojë pa argumente. Sigurisht që, mungesa e një vullneti për të arritur në një kompromis siç kërkohet nga Komisioni i Venecias, siç kërkohet edhe nga ajo marrëveshje e 24 Dhjetorit 2014, nuk është një gjë që mund të zëvendësohet me batuta. Nuk duhet të harrojmë që duhet të shkojmë drejt përfundimit me sukses të këtij procesi, përndryshe vullneti është që kjo reformë të mos bëhet nga maxhoranca. Ky ishte një shpjegim dhe një prezantim i thjeshtë dhe do tu vihet në dispozicion të gjithëve siç e premtuam”, tha Bylykbashi.

Skandali/ Rama ka premtuar lirimin e Shullazit brenda 4 muajsh, trajtim special në qeli

Tahiri zhvillon takime periodike në qelitë e paraburgimit me Milin e Partisë

Ish kryeministri Sali Berisha ka deklaruar sipas një informacioni konfidencial që disponon se Ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri zhvillon takime periodike në qelitë e paraburgimit me Emiljano Shullazin. Në një postim në facebook, Berisha sqaron në statusin e tij se këto takime zgjasin rreth 1.5 orë. Ish kryeministri thekson se në takimin e fundit oficeri dixhital informon se Edvin Shullazi i ka premtuar Milit të Partisë lirimin e tij nga burgju brena 4 muajve të ardhshëm. “Edvin Shullazi dhe Saje qorri në kontakt të rregullt me Milin e Partisë. Të dashur miq, burime nga drejtoria e

burgjeve dhe policia kriminale informojnë: Saje qorri zhvillon takime të rregullta javore, kokë me kokë në një dhomë të veçantë me Milin e partisë. Këto takime zgjasin rreth 1.5 orë. Në takimin e fundit oficeri dixhital informon se Edvin Shullazi i ka premtuar Milit të Partisë lirimin e tij nga burgju brena 4 muajve të ardhshëm. Oficeri dixhital informon gjithashtu se Milit të Partisë i janë siguruar disa shërbime të rezervuara në kësi rastesh vetëm për vipat me trajtim special duke shkelur rregullat e caktuara për sjelljen dhe qëndrimin ndaj personave në paraburgim apo burgim.

Rama i jep dorën pa lekë Obamës

80 mijë dollarët/Prokuroria e Përgjithshme do të marrë në pyetje Edi Ramën me kërkesë të FBI-së ?!

Në sajë të një arritjeje të reformave të Sali Berishës, Shqipëria ulet si e barabartë në tryezën e vendeve anëtare të NATO-s dhe këtë herë protokollit i samitit i ka mundësuar Edi Ramës t'i japë dorën presidentit të SHBA-së, pa pasur nevojë të paguajë dollarë apo të hiqet si Gruaja e Bilalit. Fotoja u keqmontua dhe u keqpërdor në Tiranë për interesat e propagandës së kryeministrit, por ajo i shërben publikut për të kujtuar se është e nevojshme thirrja e Edvinit në prokurori dhe sqarimi i burimit të 80 mijë dollarëve. Bilal Shehu, taksisti i Neë Jersey e ka pranuar se 80 mijë dollarëshi që ka paguar në fushatën e Obamës, për ti mundësuar Ramës një takim dhe një foto me presidentin amerikan, i ka ardhur nga jashtë. Nga një burim i huaj. Ekzistenca e një hetimi nga FBI mbi këtë krim federal duhet të nxisë autoritetet vendase që të hetojnë po ashtu këtë aferë kriminale. Thirrja e Bilal Shehut në prokurori tanimë është një kërkesë që vjen në kuadër të hetimit amerikan të këtij skandali, porse as Rama si "gruaja e Bilalit" nuk duhet të përjashtohet. Javën e kaluar Bilal Shehu, 48 vjeç, shtetas amerikan me origjinë shqiptare, u deklarua fajtor në gjykatë federale në Neë Jersey për dhënie me dashje të kontributeve të huaja dhe donacioneve për fushatën e Obamës. Rama ka mohuar të ketë marrë pjesë në ndonjë nga takimet elektorale të presidentit Obama, apo se ai ka paguar për bileta për ngjarjen San Francisco, edhe pse ai e pranoi se e ka takuar Shehun si "një anëtar të komunitetit shqiptar në Neë York". Edi Rama ka kryer të paktën tri vepra penale ... dhe personalisht përfituar nga kjo. Në atë kohë, Rama e ka përdorur me krenari foton me Obamën, disa muaj para

zgjedhjeve parlamentare që sollën partinë e tij në pushtet. "Kryeministri Rama nuk ka lidhje me asnjë lloj financimi të paligjshëm", thuhej në një deklaratë nga zyra e Ramës i vetmi krim "i kryer në vitin 2012 është se ai kishte një foto me presidentin amerikan në një kohë kur qeveria shqiptare dhe shefi i tij i kishte mbyllur dyert dhe marrëdhëniet ndërkombëtare të Shqipërisë. Sipas dokumentave të çështjes Shehu në ShBA, e hetuar nga FBI, ai i mori paratë nga një burim i jashtëm, i dhuroi në fondin e fushatës pa treguar origjinën e vërtetë të tyre, me qëllim që një qytetar i huaj të merrte pjesë në event. Emri i Ramës nuk u përmend në këtë çështje. Dokumentat thonë se "Shtetasit të huaj" iu mohua pjesëmarrja në event, por iu lejua një fotografi me presidentin Barak Obama. Associated Press vë në dukje se asnjë person nga ekipi i mbledhjes së fondeve të Obamës nuk u akuzua për shkelje të ligjit, përkundrazi ata janë treguar të gatshëm të bashkëpunojnë. Vendimi për Bilal Shehun do të jepet në 5 Tetor. Dënimi maksimal është 5 vjet burg dhe një gjobë prej 250 mijë dollarë.

Dëshmia e Bilal Shehut dhënë në SHBA, dhe identifikimi i Edi Ramës si (I huaji 2)

Pak kohë më parë Zëri i Amerikës publikoi edhe dëshminë e firmosur nga vetë Bilal Shehu në SHBA si bashkëpunëtor i drejtësisë ku besohet se ai ka pranuar praninë e paligjshme të një personi të emërtuar (I huaji 2) dhe që besohet se është pikërisht Edi Rama duke i identifikuar atë tangent edhe si burimin e huaj të 80 mijë dollarëve që janë derdhur në arkat e fushatës presidenciale të Obamës. Ja pyetjet që iu drejtuan në seancën gjyqësore shtetasit Bilal Shehu me banim në Paramus të Nju



Xhersit, i cili pranoi fajësinë se kishte ndihmuar për të fshehur kontribute të huaja gjatë fushatës presidenciale të vitit 2012 në SHBA.

I akuzuari i përgjigj pozitivisht të gjitha pyetjeve:

- Gjatë, ose rreth muajit tetor 2012, në Distriktin e Nju Xhersit dhe gjatë, a keni ndihmuar dhe nxitur me dijeninë dhe dëshirën tuaj individë të tjerë, duke përfshirë Shtetasin e Huaj 1, shtetas i Greqisë dhe Shtetasin e Huaj 2, për të kontribuar me rreth 80 mijë dollarë nga Personi i Huaj 1 dhe Kompania e Huaj 1 për një komision të përbashkët për mbledhje fondesh (më poshtë "Komisioni i Përbashkët për Mbledhje Fondesh"), i cili përfshinte komisionin e autorizuar të fushatës për Presidentin Obama?
- Afërsisht gjatë muajit shtator 2012, a keni mësuar rreth një plani për të mundësuar Shtetasin e Huaj 2 që të merrte pjesë në një aktivitet fushate, që do të mbahej më 8 tetor 2012, në San Francisco të Kalifornisë ("Aktiviteti i San Franciscos për Mbledhje Fondesh")?
- Gjatë, ose nga fundi i muajit shtator 2012, a mësuar gjithashtu se Komisionit të Përbashkët për Mbledhje Fondesh do t'i jepeshin fonde prej rreth 80 mijë dollarë përpara 8 tetorit 2012, me

- qëllim që dy individë të merrnin pjesë në Aktivitetin e San Franciscos për Mbledhje Fondesh në atë datë?
- A mësuar gjithashtu se, për të hyrë në Aktivitetin e San Franciscos për Mbledhje Fondesh, një jo-shtetas që kërkon të marrë pjesë duhet të jetë i shoqëruar nga një shtetas amerikan?
- A mësuar gjithashtu se, sipas ligjit amerikan, jo-shtetasi nuk mund të jetë burim i një kontributi prej rreth 80 mijë dollarësh, që do të thotë se e tërë shuma prej 80 mijë dollarësh duhet të dhurohet nga shtetasi amerikan, që shoqëron të ftuarin jo-shtetas?
- A ratë dakord të merrnit pjesë bashkë me Shtetasin e Huaj 2 në Aktivitetin e San Franciscos për Mbledhje Fondesh, për të mundësuar kështu hyrjen në Aktivitet të Shtetasit të Huaj 2 përmes statusit tuaj si shtetas amerikan?
- A ratë dakord gjithashtu të shërbenit si kontribues i shumës prej 80 mijë dollarësh për Komisionit të Përbashkët për Mbledhje Fondesh, pra të pranoni fonde prej 80 mijë dollarësh nga një burim i huaj, të cilat do t'ia jepnit pastaj Komisionit të Përbashkët, duke bërë që të dukej sikur ky ishte kontribut i juaj personal?
- Gjatë, ose nga fundi i muajit shtator 2012, a i dhatë një

tjetër individ në SHBA emrin, datëlindjen dhe informacionin tuaj personal si dhe atë të gruas suaj, me dijeninë se këto informacione do t'i jepeshin Komisionit të Përbashkët për Mbledhje Fondesh, në pritje të pjesëmarrjes suaj në Aktivitetin e San Franciscos?

9. A i dhatë të njëjtit individ informacionin e llogarisë suaj bankare, duke e ditur se ky do të përdorej për transferimin e rreth 80 mijë dollarëve, nga një burim i huaj tek llogaria juaj personale, që ju kishit rënë dakord t'ia kalonit pastaj Komisionit të Përbashkët për Mbledhje Fondesh?

10. Gjatë, ose nga fundi i muajit shtator 2012, a morët një shumë prej rreth 80 mijë dollarësh, me transfertë elektronike, në llogarinë tuaj bankare në Nju Xhersi nga llogaria e Shtetasit të Huaj 1, duke e ditur se këto nuk ishin para që ju takonin dhe që ju do t'ia dorëzonit Komisionit të Përbashkët për Mbledhje Fondesh?

11. Në ose rreth datës 29 shtator 2012, ndërsa ishit në Nju Xhersi, a i përdorët ju dhe gruaja juaj këto 80 mijë dollarë për të blerë dy çeqe bankare në emrin tuaj dhe të gruas suaj për 70 mijë dhe 10 mijë dollarë?

12. A ia dërguat ju më pas këto çeqe Komisionit për Mbledhje Fondesh për të siguruar hyrjen në Aktivitetin e San Franciscos për veten dhe për Shtetasin e Huaj 2?

13. Në fillim të tetorit 2012, a shkuaat ju me avion në San Francisco, ku shoqëruat Shtetasin e Huaj 2 në vendin ku do të mbahej Aktiviteti për Mbledhje Fondesh?

14. A iu mohua Shtetasit të Huaj 2 hyrja në Aktivitetin e San Franciscos për Mbledhje Fondesh, por iu lejua të bënte fotografi me Presidentin e Shteteve të Bashkuara?

15. Duke vënë në jetë këtë skemë, a vepruat ju me dijeninë dhe me dëshirën tuaj?

16. A jeni fajtorë për akuzën e ngritur në Informacion?

I dyshuari i Rinasit: Policia tentoi të më eliminonte, duan të më faturojnë grabitjen

Gazetari Artan Hoxha ka siguruar dëshminë e një të riu nga fshati Derven i Fushë Krujës, i cili pretendon se është qëlluar nga policia me qëllim për t'u eliminuar. Klodian Çypi, person me precedentë penalë dyshohet si i përfshirë në grabitjen e parave në Rinas. Më 1 korrik, një ditë pas grabitjes, policia ka kryer një operacion për ndjekjen e tij, por sipas dëshmisë që Çypi jep për Artan Hoxhën, është dashur eliminimi i tij fizik. Çypi rrefen se 12 persona të veshur me kapuç e kanë ndjekur dhe më pas qëlluar në afërsi të mbikalimit të Patokut. Shihni videon më poshtë që tregon makinën e qëlluar sipas tij nga

policia. "Klodian Çypi është person që është akuzuar më parë për vepra penale. Ai është nga Derveni dhe më 1 korrik ndodhej në një lokal në hyrje të Laçit. Dy persona të armatosur tentuan ta kapin brenda lokalit dhe ai është larguar menjëherë, por ndaj tij është qëlluar me armë. Madje, edhe gjatë ndjekjes së Policisë, efektivet kanë qëlluar në lartësi të mëdha, duke i rrezikuar jetën Çypit. Ai ka mundur të largohet me furistradën e tij tip "Porsche Cayenne", të cilën e ka fshehur", tha Hoxha. Më tej, në një sinkron, shihet se si makina është shpuar gjithandej nga plumbat. Në këtë video, Çypi thotë se Policia kërkonte

që ta ekzekutonte. Edhe Hoxha thotë se Klodian Çypi ka frikë se ajo kërkon që t'ia faturojë atij të tria grabitjet e bankave që kanë ndodhur. Hoxha thotë se Çypi do të bëjë vetëgjyqësi ndaj Policisë nëse nuk sqarohet ky operacion, që sipas tij është informal. "Unë kam parë edhe kamerat e sigurisë të disa bizneseve, dhe kam parë se Policia ka qëlluar ndaj Çypës në një lartësi të tillë, pra sikur kërkonte ta eliminonte. Unë i di edhe emrat e Policëve por nuk do t'i publikoj. Pretendimet e Çypit janë të rënda, ndërsa për operacionin nuk ka asgjë zyrtare", thotë Hoxha.

Të dhëna të reja nga sevdaja e Edvinit me serbët Daçiç i këndon Ramës për ditëlindje: O dielli im

Ditëlindja e kryeministrit të Shqipërisë Edi Rama, 4 korriku, ndodhi që të kremtohej gjatë mbajtjes së Samitit të Ballkanit Perëndimor në Paris. Presidenti francez, François Hollande ka shtruar një darkë mikëpritje për të gjithë kryeministrat e Ballkanit, që ishin pjesë e samitit në Paris. Në darkën solemne të Samitit, Ivica Daçiç, shefi i diplomacisë serbe, i ka bërë një surprizë kryeministrit shqiptar, duke i kënduar një këngë, shkruajnë mediat kosovare, duke cituar ato serbe. Sipas gazetës serbe "Kurir", Hollande i ka kërkuar Daçiç që të këndojë një këngë për nder të ditëlindjes së Edi Ramës. "Kurir" shkruan se "këngëtari ynë kryesor

në skenën politike nuk e ka refuzuar kërkesën". Mësohet se Daçiç i këndoi një këngë "O sole mio" ("O dielli im") si dhe "Santa Lucia". Referuar detajeve të nënvizuar nga gazeta serbe, pak para se të niste këngën, ai ka pyetur ku është orkestra? Pas kësaj performace, Hollande, Merkel dhe Mogherini e puthën dhe e përqaftuan Daçiçin për atmosferën e bukur që krijoi. Megjithatë, kjo nuk është hera e parë që ai i këndon, e aq më tepër kryeministrit shqiptar Edi Rama. Para dy vjetësh në Beograd, në samitin e Kinës dhe të 16 vendeve të Evropës Lindore e Qendrore, Edi Ramës i ishte kënduar nga i njëjti repertor, pikërisht kënga "O sole mio".

Politika e të ardhmes: Të hapur dhe të armatosur

**Nga Fareed Zakaria
(The Washington Post)**

Nëse Tony Blairi do të mbahet mend në histori vetëm për mbështetjen e dhënë prej tij për luftën në Irak, kjo do të ishte një tragjedi. Ish-kryeministri britanik ishte një nga udhëheqësit më të rëndësishëm politikë të brezit të tij, duke e nxjerrë të majtën nga shkretëtira, dhe duke e përgatitur atë për botën e pas Luftës së Ftohtë. Ai është një parashikues politik i spikatur. Rreth një dekadë më parë, ai filloi duke shpjeguar se ndarja më e rëndësishme politike për të ardhmen nuk do të ishte mes të majtës dhe të djathtës, por mes hapjes dhe mbylljes. Për të kuptuar këtë nocion – për të cilin kanë shkruar mençurisht edhe David Brooks e Alec Ross – hidhini një sy asaj që ndodhi me Partinë Republikane. GOP është përcarë jo sipas një ndarjeje e majtë – e djathtë, por në një ndarje të hapur – të mbyllur – mes atyre që favorizojnë tregtinë e lirë, imigrimin

dhe dinamizmin teknologjik, dhe atyre që u tremben këtyre forcave. Sondazhet tregojnë se republikanët janë tani më kundër tregtisë së lirë, se sa janë demokratët. Kjo ndarje të hapur – të mbyllur ka prodhuar ndasi edhe në partitë e krahut të majtë. Partia Laboriste e Britanisë është e ndarë mes të hapurve, dmth krahu i Blairistëve, dhe kuadrove të saj të vjetër, që preferojnë mbylljen. Partia Demokratike në SHBA ka përjetuar rritjen e Bernie Sandersit, edhe pse ajo mbetet relativisht e bashkuar. Shumë i shohin zgjedhjet e nëntorit si një anomali të çuditshme, një rast të rrallë. Por kjo mund të jetë një shenjë paralajmëruese e një rireshtimi politik, me Partinë Demokratike që përfaqëson gjithnjë e më shumë elitat teknokrate, profesionistët e arsimuar në kolegje, gratë që punojnë dhe minoritetet, të gjitha me një orientim të hapur drejt globalizimit. Republikanët janë duke u bërë partia e rrethëve rurale, punëtorëve e hamejve dhe kryesisht

më pak të arsimuarve, të moshuarve të bardhë – të cilët mbështesin një sistem të mbyllur të kontrollit mbi tregtinë, emigracionin dhe ndoshta edhe teknologjinë. Për ata prej nesh që besojnë në hapjen, duket qartë se përgjigja për problemet tona nuk është ngritja e barrierave ndaj tregtisë dhe investimeve. Ne jetojmë në një ekonomi thellësisht të ndërlidhur globalë të furnizimit. Ne nuk mund të përmbysim këto tendenca. Shumica e produkteve “amerikane” sot janë të prodhuara, të bëra dhe të montuara në shumë vende të tjera. Ndryshimi i tarifave në një ose dy vende – Meksikë dhe Kinë – nuk do të sjellë mbrapsht vendet e punës në Amerikë. Do t'i shpjerë ato në Peru dhe Vietnam. Por si për t'i përgjigjemi shqetësimit shumë real, se lëvizja e lirë e kapitalit, mallrave, shërbimeve dhe njerëzve nuk ka sjellë dobi për punëtorët e zakonshëm amerikanë? Përgjigjet mund të gjenden në kërkimet e

kryer nga Eduard Aldeni dhe Rebecca Straussi, bashkë me një ekip në Harvard Business School. Ata theksojnë se pozita relative e ekonomisë së SH.B.A. në fakt është përmirësuar në vitet e fundit. Më shumë se gjysma e 100 kompanive më të mëdha në botë janë amerikane, dhe ato që dominojnë në epokën dixhitale – Google, Facebook, Amazon janë pothuajse të gjitha amerikane. Por Shtetet e Bashkuara nuk kanë investuar mjaftueshëm për punonjësit e vet – në aftësitë e tyre, arsimin, infrastrukturën dhe qasjen tek kapitali – në mënyrë që ata të prosperojnë, së bashku me korporatat e vendit. Për shembull, Alden dhe Strauss shënojnë se qeveria e SHBA shpenzon një lëmoshë për rikualifikimin në punë dhe masat e lidhura me të: 0.1 për qind të prodhimit të brendshëm bruto, krahasuar me 0.8 për qind në Gjermani dhe 2.3 për qind në Danimarkë. Shtetet e Bashkuara shpenzojnë

shumë për arsimin, por jo në mënyrë të efektshme dhe kryesisht për fëmijët tashmë të pasur dhe të mirë-përgatitur. Infrastruktura është e keqe dhe transporti publik edhe më keq, kështu që punëtorët nuk mund të lëvizin lehtësisht për vende të reja pune. Këto lloje investimesh do të lejonin punëtorët amerikanë që të ndanin prosperitetin e përgjithshëm të ekonomisë. Politika e zgjuar e të ardhmes do t'i japë përparësi të qenit “të hapur dhe të armatosur”, të gatshëm për të konkurruar në një ekonomi globale dhe të pajisur me një “armaturë” mjetesh dhe trajnimit. Kjo do të kërkojë një seri shumë më ambicioze programesh të qeverisë. Ne do të duhet rikualifikojmë njerëzit në shkallën e Ligjit, në dispozicion për çdo punëtor, në çdo moment në karrierë së tij ose të saj. Kushdo që punon me kohë të plotë duhet të ketë një pagë të mirë. Ndoshta në fund ne kemi

nevojë për të ardhura themelore universale, për të zëvendësuar një model të vjetëruar dhe joefikas të mirëqenies sociale. Sandersi shpesh ka thënë se Shtetet e Bashkuara duhet të shikojnë tek vende të tilla si Danimarka dhe Suedia dhe të imitojnë politikën e tyre ekonomike. Kjo është një ide e mirë. Por ai mund të mos kuptojë se të gjitha vendet skandinave janë tregtarë të lirë të patundur – në fakt, ata renditen më lartë për tregtinë e lirë, në Indeksin e Lirisë Ekonomike të Fondacionit Heritage, se sa Shtetet e Bashkuara. Të gjithë janë bujarë me imigrantët. Suedia ka edhe një përqindje më të lartë të njerëzve të huaj të lindur, se sa Amerika. Por këta vende kanë kombinuar këtë hapje, me politika të forta efektive që u japin qytetarëve të tyre aftësitë, kapitalin, infrastrukturën dhe frymëmarrjen, që u nevojiten për të patur sukses në botë. Vendet e Skandinavisë janë më të hapur se Amerika, dhe shumë më mirë të armatosur.

Përse Clintonët i shpëtojnë gjithmonë “sëpatës”

“The Week”

A u habitët nga mënyra se si përfundoi hetimi i e-maileve të Hillary Clintonit? Nëse po, ju ose nuk keni jetuar deri më 1990, ose i keni shtypur kujtimet tuaja, në mënyrë të pamëshirshme. Hetimi në serverin privat të emailit, të kandidatës demokrate, që ajo e përdorte kur ishte Sekretare e Shtetit, kishte të gjitha tiparet e një skandali “Clinton” nga e shkuara. Pati një pritshmëri jorealiste në mesin e republikanëve, se më në fund ky do të ishte skandali që do fundoste Clinton-ët, ndoshta edhe duke i dërguar ata pas hekurave. Ishin edhe mbrojtësit nga Partia Demokratike, që mohonin jo vetëm tmin, por edhe çdo mundësi të zjarrit. Pastaj, në fund, ishin njerëzit me fuqinë për të bërë një ndryshim, që vendosën t'u japin një leksion Clinton-ëve, por jo t'u shkaktonin ndonjë pasojë reale. Këtu James Comey shkoi në rrugën e Joe Liebermanit në vitin 1998. Sigurisht, atëherë kishte një dallim të madh: Lieberman po bënte një gjykim moral të sjelljes së Billit. Comey po shpaloste një seri të gjetjeve, të cilat, “vdekatarëve” të tjerë



do u hapnin telashe me ligjin, ose edhe mund t'u rrezikonin vendin e punës. Por kur vjen puna tek skandalet e Clintonëve, Republikanët gjithmonë arrijnë të duken pakëz më të etur, pak si shumë partiakë. Ata ndjekin me të njëjtën forcë, si akuzat e rënda kundër Clintonëve, ashtu edhe ato më joserioze. Në këtë drejtim, ata janë pothuajse mbështetës të mbrojtësve më të paturpshëm të Clintonëve. Republikanët ose e teprojnë, si për shembull ndjekin një “impeachment” aspak popullor, pavarësisht se nuk ka një shteg bindës

drejt dënimit në Senat, ose shohin pyllin dhe thonë ku janë pemët, si për shembull kur nuk u morën aspak me zgjerimin e hetimit të Benghazit, për të ofruar një panoramë të plotë të ndërhyrjes katastrofike në Libi, të udhëhequr nga Clinton. Skandalet Clinton janë bërë pothuajse të endura në pëlhurën politike. Konsumatorët konservatorë mund të mblidhen me krikla birre dhe bluza ku shkruhet: “Unë jam i gatshëm që Hillary të shkojë në burg”, ose ta paraqesin atë me një uniformë portokalli, por për gjithë

të tjerët, është vetëm zhurmë ambienti. Edhe kur njerëz të arsyeshëm mund të mos pajtohen në lidhje me dobinë e goditjes së Clintonëve mbi skandalet themelore, shpesh herë polemikat përcaktohen nga fraza tipike të pasinqerta, si: “Unë nuk kam patur marrëdhënie seksuale me atë grua”; “Pa autoritet ligjor kontrollues”, apo “Varet se cili është kuptimi i ‘është’”. Më e pakta, mbrojtja kyçe e Clintonit për skandalin e emaileve duket të jetë e rremë. Ajo tha se asnjë email që ndodhej në serverin e saj nuk ishte i klasifikuar në

atë kohë, kur ajo i dërgoi dhe i mori. FBI zbuloi se nuk ishte kështu. Ajo tha se nuk kishte shanse që hackerat të kishin hyrë në serverin e saj. Comey pranoi se të paktën ishte mundshme, ndërkohë që “ne vlerësojmë se aktorë armiqësorë siguruan qasje në emailin privat të njerëzve, me të cilët Sekretarja e Shtetit ishte në kontakt të rregullt, nga llogaria e saj personale e emailit”. Clinton këmbënguli se kishte dorëzuar të gjithë emailt me materiale pune, por kjo nuk është ajo që zbuloi hetimi. Për më tepër, deklarata e Comeyt përfshinte edhe këtë: “Është gjithashtu e mundshme që të ketë të tjera emaile, të lidhura me punën, që ata nuk ia dorëzuan shtetit dhe që nuk i kemi gjetur askund tjetër, dhe që tani kanë humbur, sepse ata i fshinë të gjitha emailt që nuk dorëzuan. Avokatët i pajisjet e tyre në mënyrë të tillë që të parandalonin rikthimin të tyre”. Edhe pretendimi i saj se e gjithë kjo kish ndodhur për shkak të thjeshtësisë së përdorimit të vetëm një pajisjeje, nuk i shpëtoi këqyrjes së FBI-së. Duke qenë se Clintoni nuk u akuzua, mbështetësit e saj do të pretendojnë

se ajo u shfajësua dhe ata janë të përligjur, pavarësisht nga “pakujdesia ekstreme” në trajtimin e të dhënave të ndjeshme të qeverisë, “provave të shkeljeve të mundshme të statuteve lidhur me trajtimin e informacionit të klasifikuar,” situatave që “çdo person i arsyeshëm në pozitën e Sekretares Clinton duhet të kishte ditur ...”. “Për të qenë të qartë, kjo nuk do të thotë se në rrethana të ngjashme, një person i cili i angazhuar në këtë veprimtari, nuk do të përballej me pasojat”, tha Comey. “Përkundrazi, këta individët shpesh herë u nënshtrohen sanksioneve mbi sigurinë, apo atyre administrative”. Republikanët në Kongres do të përpiqen të sigurohen që për Clintonin do të ketë pasojë, me një seri dëgjimesh dhe deklaratash zemërimi. Por këto përpjekje nuk do të shpien askund, sepse ato nuk do të merren seriozisht nga shumë njerëz, që nuk janë as republikanë partiakë, as urryes të dedikuar të Clintonëve. Këshilla që do u jepte cilido që ka parë “Clueless” në kinema: Nëse keni parë një skandal të Clintonëve, atëherë i keni parë të gjithë. Përkthimi në shqip u publikua së pari në “bota.al”

Kryetari i KLSH takon Ambasadorin e BE-së dhe Ambasadorin Austriak

Bujar Leskaj: KLSH, e vendosur për të forcuar kapacitetet audituese

Kryetari i KLSH, Bujar Leskaj takoi Ambasadorin e Bashkimit Evropian në Shqipëri, zj. Romana Vlahutin dhe Ambasadorin e Austrisë në Shqipëri z. Johann Sattler. Kryetari Leskaj falenderoi në mënyrë të veçantë Ambasadorin Vlahutin për ndihmën konstante dhe të çmuar të dhënë nga BE për institucionin më të lartë të auditimit publik në Shqipëri, të kulmuar me projektin e binjakëzimit IPA 2013 për modernizimin e kapaciteteve audituese të KLSH-së, i cili ka nisur të zbatohet. Leskaj cilësoi se tani kjo ndihmë është parësore për institucionin që ai përfaqëson, për forcimin e kapaciteteve audituese sipas praktikave më të mira evropiane dhe pikërisht për këtë

Projekti IPA për KLSH bashkon institucionin suprem të auditimit-SAI-n e Polonisë (NIK) me Zyrën Shtetërore të Auditimit të Kroacisë, ndër SAI-t më të zhvilluara të Evropës. Mbështetja e BE-së me Projektin IPA vjen pas përkrahjes së dhënë një vit më parë nga Drejtorja e Përgjithshme e Buxhetit DG-Budget në Bruksel dhe nga ekspertët të angazhuar nga Delegacioni i BE në Tiranë, për miratimin e Ligjit organik të ri të KLSH-së tërësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare të INTOSAI-t. Nga ana e saj, Ambasadorja Vlahutin konfirmoi angazhimin e plotë të Bashkimit Evropian në modernizimin dhe forcimin e kapaciteteve audituese të KLSH dhe



theksoi interesin që ka BE në përdorimin me efektivitet të parësor publik në Shqipëri. “Në këtë drejtim”, theksoi ajo, “transparenca dhe cilësia e raportimit të auditimit shtetëror për parane publike të harxhuar është me shumë rëndësi për

shëndoshjen e financave publike në vend”. Ajo përmendi mbështetjen financiare të BE-së për Buxhetin e Shtetit të Shqipërisë dhe u shpreh se kjo asistencë ka si kusht për disbursimin e saj kontributin e efektshëm dhe sipas standardeve ndërkombëtare të

kërkuara të mbikqyrjes së jashtme ndaj financave publike, të përfaqësuar më së miri nga institucioni i KLSH-së. Ambasadori i Austrisë z. Johann Sattler vlerësoi bashkëpunimin e suksesshëm që KLSH ka me Gjykatën Austriake të Auditimit, pas marrëveshjes së nënshkruar në Vjenë nga këto dy institucione partnere, si dhe përmendi kontributin e fundit të SAI-t austriak me raportin e Peer Review (Rishikimit mes Kolegëve), raport të cilin KLSH e ka marrë ditët e fundit dhe që i shërben institucionit për të matur dhe krahasuar performancën e tij sipas standardeve më të mira evropiane të fushës. Leskaj e cilësoi Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike 2014-2020 si

themelore për arritjen e objektivave të zhvillimit makroekonomik të vendit. Ai përmendi se kjo Strategji është e përgatitur me ndihmën e ekspertëve të BE-së dhe të SIGMA-s dhe theksoi mendimin që KLSH ka paraqitur dhe në Komisionin e Kuvendit për Ekonominë, sipas të cilit përgjegjësia për zbatimin e objektivave dhe treguesve të Strategjisë nuk duhet të ngelet tek një njeri i vetëm, Ministri i Financave, por të shtrihet tek të gjitha institucionet kryesore zbatuese, duke përfshirë edhe KLSH. “Ne si KLSH jemi të përkushtuar për zbatimin me sukses të Shtyllës së Gjashtë të Strategjisë, mbikëqyrjen e financave publike”, përfundoi kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Salianji në Berat: Qeveria e ka braktisur totalisht qytetarin, mbështet grupe të vogla klienteliste

Fermerët e fshatrave Kuç, Çiflig, Arrëz e Banaj në protestë, janë përmbytur tre herë, asnjë qindarkë dëmshpërblim nga qeveria

Fermerët dhe banorët e fshatrave të Beratit protestuan për mashtrimin e qeverisë me dëmshpërblimin ndaj tyre. Dhjetëra hektarë janë përmbytur dhe qindra tonë prodhime bujqësore janë shkatërruar nga përmbytjet e tri viteve të fundit, dhe qeveria ka qenë inekzistente nuk u ka kushtuar asnjë vëmendje. Kanë humbur gjithë pasurinë dhe nuk kanë sot me çfarë të jetojnë. Banorët e fshatrave fshatrave Kuç, Çiflig, Hink, Arrëz e Banaj nuk u kanë investuar mundin dhe sakrificën e gjithë jetës në fermtat dhe tokat të cilat u përmbytën tri herë. Sekretari për Aksionin Qytetar në PD, Ervin Salianji dhe dega e PD në Berat duke mbështetur protestën e fermerëve theksuan se qeveria dhe Edi Rama grabisin fshatarët me niptet dhe taksat e larta dhe nuk denojnë as të zbresin në terren e të dëgjojnë hallet e banorëve

të cenuar nga përmbytjet. “Të gjithë vuani nga një gjë, jeni braktisur nga qeveria. Gjithë investimin e jetës e keni hedhur në bujqësi sepse bujqësia është jeta juaj, tek toka, në bujqësi keni hedhur mundin, djersën, sakrificat e një jete, bukën e fëmijëve, dhe e gjitha u është përmbytur nga fatkeqësi natyrore. Jo vetëm që nuk po ju japin para, por nuk ka ardhur t’u dëgjoj asnjëri. Ky është një problem i gjithë komunitetit. Qeveria e ka braktisur totalisht qytetarin. Siç ka ndodhur këtu tek ju që i ka dhënë lekët tek një grup i ngushtë që kanë ngritur sera për të marrë lekët tuaja, ashtu po funksionon në të gjithë Shqipërinë. Qeveria nuk shkon pranë qytetarit nuk e dëgjon atë, nuk vjen këtu dhe ti japë zgjidhje. Sepse në fund të fundit për çfarë e duam qeverinë? Qeveria votohet nga ju, paguhet nga taksat e juaja

dhe nga qytetarët e tjerë pikërisht për të ardhur dhe për ti dhënë zgjidhje problemeve. Qeveria mbështet importuesin i cili fiton miliona në kurrizin e djersës dhe mundit tuaj, vetëm e vetëm se është klient i qeverisë, dhe ka lidhje të drejtpërdrejta me ministrat me kryetarin e bashkisë dhe me deputetët e PS, që ju vijjnë këtu vetëm për zgjedhje. Ne sot nuk jemi në fushatë por kemi ardhur të dëgjojmë e të diskutojmë për problemin tuaj dhe këtë problem e kemi ngritur dhe do të vazhdojmë ta ngremë publikisht do e ngremë zërin në parlament, do ta trajtojmë në departamentin e Bujqësisë në PD dhe ju garantoj që gjithë mundi juaj do të shpërblehet sepse në fund të fundit paratë e qeverisë nuk janë paratë e qeveritarëve por janë paratë tuaja të cilat duhen administruar për ju”, u shpreh Salianji. “Dega e PD, Berat

mbështet protestën e fermerëve të fshatrave Kuç, Çiflig, Hink, Arrëz, Banaj, të cilët janë përmbytur. Megjithëse u është premtuar që do të dëmshpërblehen nga ana e qeverisë dhe qeveria ka akorduar nëpërmjet fondit të emergjencave një fond të posaçëm, deri më sot kanë përfituar vetëm njerëzit që kanë qenë afër PS. Paratë taksat e këtyre fshatrave dhe gjithë qytetarëve shqiptarë po trajtohen si pronë dhe si çiflig i partisë në pushtet. PD është e vendosur të mbështesë fermerët deri në dëmshpërblimin e tyre duke përshkallëzuar protestën”, tha kryetari i PD-së së Beratit, Gazmend Azizi. “Unë kam në Sheq dy dylmë e gjysmë mandarina të përmbytura. Uji qëndroi mbi një muaj e kusur. Qeverinë as e kam parë e as kam dëgjuar. Kam tre dylmë grurë dhe kam marrë vetëm katër kuintalë grurë se është

përmbytur”, u shpreh një banor. “Unë kam tre dylmë sera, më është përmbytur në nëntor të 2014 dhe në shkurt të 2015. Dy herë jam përmbytur. Qeveria nuk ka marrë masa për asgjë, ndau ca lekë sivjet. Kemi bërë aplikime por s’kemi marrë lekë. Nuk na përfshijnë tek dëmshpërblimet”, u shpreh një kryefamiljar i zonës. “Kërkojnë tatimet këta, kërkojnë nipte po malli që është prishur, apo që nuk shitet ku ta çojmë. Këta na blenë ne ullirin, mandarinën, plehun kimik, që tani na kërkojnë lekët, taksat?”, ankohet një tjetër. “Jam përmbytur dy herë në nëntor të 2014 dhe në shkurt të 2015. Fusha ka mbetur pesë ditë nën ujë, kam mbjellë shtatë dylmë mandarinë. Investimi im është tetë milion lekë. Kam blerë 400 mijë rrënjë mandarinë. Nga shteti nuk është vënë dorë fare. Ka ardhur një herë ministri i bujqësisë

dhe Edi Rama ka bërë një mbledhje lart, na ftuan të merrnim pjesë në takim, por pastaj na thanë largohuni se do ulen dhe do bëjnë pyetje vetëm gazetarët, nuk na premtuan asgjë. Unë i kërkoja ministrit të ndërtohen kanale, por ata vijjnë vetëm për fushatë”, thotë një fermer. “Mua më është prishur një autokombajnë me vlerë dy milion e gjysmë lekë. Na kanë shkuar dëm kuintalë të tërë ullinj, dy kuintalë qepë, 50 gjela deti dhe dhjetëra kuintalë mandarina. Nuk më ka ardhur njeri të më pyesë as edhe çfarë dëmshkam pasur”. “Pata tre dylmë fasule dhe grurë dhe ato mu përmbytën. Kam një invalid të sëmurë në shtëpi dhe dy pleq të moshuar që i mbaj unë me punën time në bujqësi. Rropatëm gjithë ditën dhe sera ime është përmbytur katër herë këto vite. Lekët i kanë marrë njerëzit pranë pushtetarëve”, denoncon një nënë.

Kampionati i karatesë, kreu Basha takon 17-vjeçarit fitues të medaljes së argjendtë

Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha priti në një takim Bekim Bashën, fituesin e medaljes së argjendtë në Kampionatin Botëror

të karatesë. Basha ka vlerësuar vullnetin e hekurt të 17-vjeçarit Bekim Basha, përmes të cilit ia ka dalë të përmbushë qëllimin e tij dhe të ngrëjë flamurin

shqiptar mes 54 shteteve të botës që morën pjesë në kupën e botës zhvilluar në Kroaci. Kreu Basha ka shprehur domosdoshmërinë e mbështetjes së talentëve

të sportit si Bekimi të cilët ndonëse jashtë vëmendjes mediatike dhe të qeverisë kanë shkëlqyer në kompeticione ndërkombëtare duke ngritur

lart emrin e Shqipërisë dhe flamurin kombëtar e duke u nderuar me medalje. Mbështetja e tyre financiare, krijimi i kushteve për stërvitjen e tyre do të

jetë prioritet i Partisë Demokratike, pasi qeveria nuk mund të investohet vetëm për të përfituar nga suksesi i sportistëve tanë, theksoi zoti Basha.

Në Dallas, qëllohen të paktën 11 policë, 5 të vrarë - a po shkon SHBA drejt luftës civile?

Pesë policë u vranë dhe 6 të tjerë u plagosën të enjten mbrëma në qytetin jugor amerikan Dallas të shtetit Teksas, gjatë një tubimi proteste kundër asaj që shihet gjerësisht si përdorim i tepruar force nga policia ndaj dy afrikanë-amerikanëve në Minesota dhe Luiziana. Policia u kërkoi demonstruesve që të largoheshin nga zona në të cilën po qëllohej me armë, jo shumë larg nga vendi ku në vitin 1963 u vra presidenti John Kennedy. Një person që ndodhej aty në kohën e të shtënave me armë e përshkroi skenën si «kaos i plotë». Shefi i

policisë në Dallas tha të premtën në mëngjes se tre të dyshuar janë arrestuar, ndërsa i dyshuari i katërt është vrarë. Në një deklaratë për gazetarët, Shefi i Policisë, David Brown tha se i dyshuari i katërt u vra, pasi hodhi veten në erë gjatë konfrontimit me policinë. Shefi i policisë tha se në fjalët e tij të fundit, ai kishte shprehur revoltim për vrasjen e afrikanë-amerikanëve nga policët dhe se donte të vriste shtetas të racës së bardhë. Ai kishte aluduar se do të ketë vdekje të tjera nga mjete plasëse të vëna në qytet. Autoritetet

në Dallas kanë dërguar ekipe speciale për zbulimin dhe detonimin e bombave, por nuk kanë gjetur gjë. Në komentet për shtyp sot në mëngjes, Kryebashkiaku i Dallasit Mike Rawlings u shpreh se ishte një ditë e dëshpëruar. “Kur themi se policët tanë vënë jetën në rrezik çdo ditë nuk është ekzagjerim, është në fakt realitet”. Në komentet që bëri në Varshavë, Presidenti Barak Obama i dënoi sulmet, duke i cilësuar një kujtesë e dhimbshme e sakrificave që bëjnë përditë policët për të garantuar sigurinë e popullatës:

“U bëj thirrje të gjithë amerikanëve të luten për këta policë dhe familjet e tyre, t'i mbajnë në mendjet e tyre. Si komb, të shprehim të gjithë mirënjohjen tonë të thellë për djemtë e vajzat tona në uniforma blu, jo vetëm sot, por çdo ditë”. Policia thotë se snajperët hapën zjarr mbi policët gjatë demonstratës që po zhvillohej mbrëmë për të protestuar vrasjet e dy afrikanë-amerikanëve këtë javë nga policia, një në Minesota dhe një në Luiziana. Dy vrasjet janë incidentet më të fundit në vrasje të bujshme të afrikanë-amerikanëve

nga policë, që shihen si shembuj të përdorimit të tepruar të forcës policore ndaj pakicave. Presidenti amerikan, Barack Obama, tha se sulmi fatal kundër oficerëve të policisë në Dallas, ishte akt “mizor, i kalkuluar dhe i neveritshëm” dhe se ai nuk mund të arsyetohet. Këto komente Obama i ka bërë sot në Varshavë, ku po merr pjesë në samitin dyditësh të NATO-s. Nga Varshava, presidenti Obama dënoi sulmet dhe u zotua që t'i sjell para drejtësisë personat përgjegjës. “Ka pasur një sulm të ligë, të përllogaritur mirë

dhe të neveritshëm ndaj forcave të zbatimit të ligjit”, tha Obama gjatë një konference për media, duke shtuar se zyrtarët policorë ishin shënjestruar nga disa të dyshuar. “Pa dyshim që duhet të mësojmë më shumë rreth motiveve të tyre të liga. Le të jemi të qartë. Nuk ka asnjë arsytim të mundshëm për këso lloj sulmesh apo çfarëdo akti të dhunës kundër forcave të rendit”, tha Obama. Ai shtoi se kushdo që është i përfshirë në vrasje të pakuptimta do të mbajë përgjegjësi të plotë dhe se për këtë do të vendos drejtësia.

Shqipëria ka dështuar të mbrojë shqiptarët e trojeve

Nga Reldar Dedaj

Tani, pas vrasjes barbare të katërvjeçarit Almir Aliu në Kumanovë ka ardhur koha që Shqipëria duhet të pranojë pafuqinë e saj, si dhe duhet të veprojë si pasojë e kësaj. Dhe duhet të veprojë shpejt. Kushdo që pretendon se është i izoluar nga infektimi, rrezikon t'i përkeqësojë gjërat, për vete dhe për të tjerët. Dhe është në prag të një zgjimi të fortë. Nëse Maqedonia reagon vetëm për tre fshatra të Prespës me një grusht banorësh edhe kur u mungon energjia elektrike, çfarë reagimi duhet të presim nga Shqipëria në rastin e një vrasjeje si pasojë e urrejtjes etnike ndaj popullsisë shqiptare në Maqedoni. Por kombet me ndërjegje nuk mbyten aksidentalisht, veçse atëherë kur i heqin shtyllën kurrizore, i lënë në errësirë, si një anije që është shmangur tashmë nga drejtimi, është pa kapiten, pa pikësynim, pa pamje të qartë, pa busull, në një det me dallgë, dhe ku pritet nga çasti në çast mbytja e saj. Ne jetojmë në një kohë kur ëndrrën për të pasur një “çati mbi kokë”, nuk mund ta kenë të gjithë shqiptarët. Por lidhur me këtë, lind një pyetje e logjikshme: A mund të quhet strehë mbi kokë një shtet që nuk denjon të reagojë për një komunitet që ka jashtë trojeve të saj dhe është mbi dyzet përqind e popullsisë së një shteti tjetër. E thënë ndryshe, a duhet të mbrojë Shqipëria “minoritetin” e vet kombëtar, e aq më tepër kur ai është pjesë e sulmeve të njëpasnjëshme etnike nga etni të tjera? Mosreagimi i qeverisë shqiptare për rastin e vdekjes së katërvjeçarit nga Kumanova, nuk tregon asgjë tjetër, veçse një komb të mbytur. Ç'ju duhet atyre Europa e bashkuar me një Shqipëri të copëtuar në të. E pazonja për t'u mbrojtur, madje

e pazonja për të folur. E aq më tepër, kur janë të vetëdijshëm se si duhet të jetojnë në një shtet si Maqedonia, në të cilën ëndrra e atyre që vetveten e quajnë maqedonas, është që ata të jenë pronarë të shtetit, ndërsa shqiptarët qiraxhinj në të. Fatkeqësisht, shqiptarët e përjetojnë çdo ditë në shtetin ku jetojnë. Sepse nuk ka kush t'i mbrojë. Por ndodh thujse e kundërta! Na thoni një projekt mbarëshqiptar, të cilin e përkrahin të gjitha qeveritë e “Shqipërive” tona, e që ka të bëjë me mbrojtjen e interesit mbarëshqiptar? Na thoni, pse Tirana e Prishtina zyrtare lënë përshtypjen se as që e dinë se ku ndodhet shtëpia e Kongresit të Alfabetit?! Na thoni, për shembull, pse pushtetarët në Tiranë e Prishtinë nuk heqin dorë nga darket e drekat që i paguajnë me parat e popullit, e që me ato para të ndërtojnë ndonjë shkollë në Luginën e Preshevës. Na thoni pse heshtin kur i vrasin, i rrahin dhe i shajnë? Të besosh do të thotë t'u japësh jetë gjërave. Por fatkeqësia e tyre është sot se ata s'mund të besojnë, as t'u japin jetë gjërave. Nuk duan më të besojnë nga frika se mos bëhen qesharakë. Shqiptarët janë në mëshirë të fatit. Edhe pse flitet pak për luftë, shqiptarët vazhdojnë të vriten, por harrojnë se ata po vriten, burgosen, ofendohen, rrihen dhe masakrohen për asgjë tjetër, veçse, për liri dhe dinjitet. Ngado që të shkosh në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe në të gjitha trojet shqiptare, do vësh re, se do ndihesh i shtypur nga mungesa e plotë e jetës, ritmit, fëmijëve, të ardhmes. Shqipëria as nuk ëndërron më. Edhe ëndrrën e ka vdekur, hapësirën e vetme të lirisë. Shterrimi shpirtëror çon në mumifikimin e një kombi.



Samiti i NATO-s: Në fokus Rusia, ISIS-i dhe Brexit-i...

Evropa e Lirë

Udhëheqësit botërorë që janë mbledhur në një samit të NATO-s në Varshavë, kanë thënë se aleanca është e vendosur që të përballet me sfidat që paraqet një Rusi agresive, pastaj grupi militant Shteti Islamik, vendimi i Britanisë për të braktisur Bashkimin Evropian dhe kriza me refugjatë në Evropë. Në një koment të publikuar në gazetën Financial Times, disa orë përpara fillimit të samitit dyditësh në Varshavë, presidenti i Shteteve të Bashkuara, Barack Obama, ka thënë se “ky mund të jetë momenti më i rëndësishëm për aleancën transatlantike që nga përfundimi i Luftës së Ftohtë”. Pjesa më e madhe e fokusit të samitit është Rusia, e cila ka zemëruar Perëndimin me aneksimin e paligjshëm të Krimesë në vitin 2014 dhe më ndërhyrjen e saj në konfliktin ushtarak në lindje të Ukrainës. “Agresioni i Rusisë në Ukrainë kërcënon vizionin tonë për një

Evropë të tërë, të lirë dhe në paqe”, ka shkruar Obama. Ai ka vënë theksin edhe te sulmet e Shtetit Islamik, të cilat, sipas tij, “kanë masakruar njerëz të pafajshëm në vendet e NATO-s nga Orlando deri në Paris, Bruksel e Stamboll”. “Besoj se vendet tona duhet të kenë vullnet politik dhe të bëjnë angazhime konkrete për t'u përballur me këto sfida”, ka shkruar Obama në Financial Times. Ndërhyrja e Rusisë në Ukrainë ka rritur shqetësimet në vendet lindore të NATO-s, përfshirë Poloninë dhe shtetet e Baltikut: Estoninë, Letoninë dhe Lituaninë, të cilat kanë qenë nën kontrollin e Moskës deri në rënien e komunizmit dhe në shpërbërjen e Bashkimit Sovjetik, një çerek shekulli më parë. Udhëheqësit e Finlandës dhe të Suedisë po marrin pjesë në samitin e NATO-s për herë të parë, gjë që tregon për rritjen e bashkëpunimit në kohën e rritjes së aktiviteteve ushtarake të Rusisë pranë kufijve të tyre.

Duke folur në një forum të eksepertëve, përpara fillimit formal të samitit, sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka thënë se aleatët do të pajtohen në Varshavë për vendosjen e batalioneve shumëkombëshe në Poloni dhe në shtetet e Baltikut. Batalionet do të përbëhen nga 1,000 trupa dhe do të udhëhiqen nga Kanadaja, Gjermania, Britania dhe Shtetet e Bashkuara. Ky është forcimi më i madh i mbrojtjes kolektive që nga përfundimi i Luftës së Ftohtë, ka thënë Stoltenberg. “Kemi qëndrim të përbashkët ndaj Rusisë: Bashkimi Evropian ka ndërmarrë sanksione ekonomike; NATO ka bërë rritjen më të madhe të mbrojtjes kolektive që nga fundi i Luftës së Ftohtë”, ka thënë ai. Në një intervistë për gazetën Kommersant, ambasadori i Rusisë në NATO, Aleksandr Grushko, ka thënë se aleanca ka “agjendë konfrontuese” dhe se Moskë do të ndërmarrë kundërmasa

Profil/Pjetër Arbnori, simboli i qëndresës dhe tolerancës

Pjetër Arboni do të mbamendet gjatë në kujtesën e gjeneratave, kjo jo vetëm se përfaqësoi njeriun e përkorë, politikanin tolerant por dhe shkrimtarin disident dhe penën thukët të shëmbëllimit të një shpirti sa delikat aq dhe luftarak. Sot 10 vite më parë më 8 korrik 2006 në një klinikë në Napoli, Pjetër Arbnori, pas një sfide të pamundur me sëmundjen që e kish kapluar, zemra e tij pushoi për ta ndalur rrugën për më tej, pas një hemorragjie cerebrale. Ai u shua dhe iku pa shumë bujë, siç ndodhë rëndom me njerëzit e mirë, me ata që u ndëshkuan nga fati dhe idealet, por mbeti në të sotmen, shembull i mirë i politikanit, përkushtues i familjes, ngulmëtar i aspiratave dhe vetmohues.

Prolog - Një burrë shtatshkurtër, me kokën që mban ulur sikur numëron hapet që hedh, kalon hyrjen kryesore të godinës trekatëshe; sendërgjon një përsëritje që merr formë përmes zërit që i kumbon prej zhguallit të një timbri paqtues, teatralitetit të dorës dhe buzëqeshjes që shkruhet me shumë dëlirësi në portretin e tij. Pëshpërinë ato hapa të lehtë në korridorët e selisë së Partisë Demokratike për tu shtetur nga shikimit në kthinat ku e shtegton për në zyrën e tij, gjysmëdrita e zvergët. Ky ishte rituali i përditësuar i politikanit, demokratit, themelartit dhe drejtuesit të PD, e mbi të gjitha shkrimtarit disident, Pjetër Arbnori. E ndërsa rrekemi të ravijëzojmë nëpërmjet një ndërmondje të vagullt portretin e këtij burri të pasuoq, këtij fisniku që erdhi dhe u fik ndër ne si një pishtar, këtij intelektual qëndrestar, kësaj pene të mendimit disident, këtij shpirti të kurajshëm e zemre delikate, veçse një mirënjohje e përunjur, kurrëka tjetër nuk bën fajde. Ai si erdhi iku, për të mbetur, jo një Shën Pjetër, por një dishepull i tij. Tek Pjetër Arbnori, Partia Demokratike kishte të mishëruar udhëheqësin dhe themeluesin e saj të mençur, të vendosur,

të shquar; letrat shqupe tek ai ngulmonte njërin prej kalorësve më të zëshëm të disidencës; shoqëria shqiptare, humanistin e madh, bashkëvuajtësin, simbolin e qëndresës dhe sakrificës së mbinjerëzores, “Mandelën” e Ballkanit. Pjetër Arbnori, përkarshi krejt kësaj shpërfaqje mbetet i ngulmët si përfaqësuesi i denjë i letërsisë shqipe, asaj letërsie të shkruar në kushtet e terrorit. Ai do të mbetet një ikonë e historisë së re të pluralizmit shqiptar, përfaqësues dhe zëdhënës i shtresës më të nëpërkëmbur të shqiptarëve gjatë 50 viteve të diktaturës. Si politikan, ai formësoi një figurë dinjitoze në politikën zallamahishme shqiptare, e vlefshme për t’u respektuar për ekuilibrin, tolerancën dhe vetëpërbajtjen, derimsot e mbetur vetanake në mbamendjen e gjeneratës. Si deputet i plejadës së parë politike të viteve ’90, ai ishte dhe mbeti deri në fund pjesë e filozofisë liberal-demokrate, me frymë të theksuar sociale. Ndërsa, si Kryetar i Parlamentit, ligjvënës ai do të mbetet në kujtesën e të gjithëve si një personalitet që të kujton figurat më të ndritura shtet-formuese shqiptare. Sa jetoj ia doli të mbushte me një densitet të lartë kumtues, gol-gotën e tij të mundimshme me shëmbëllimit më të përkorë të një vullneti liric. Në këtë kalvar të stërgjatë që gjarpëronte nëpër skutat më të terrta të ferrit komunist dhe vërshimet e përbindshme të llavës së ngadhënjimit, ai mbeti shpirtshëllyer. Prej nistores deri në të mbramë, Pjetër Arbnori mundi të sillte në jetë veprimtarin politik të zellshëm dhe të apasionuar, një krijues plot sqimë dhe dritëkungues, një njeri i ndershëm dhe i urtë. Jetoj fatin e tij tragjik pa u ankuar.

Rrugëtimi i korifeut - Rrugëtimi i Pjetër Arbnorit si korife i veprimtimit dhe mendimit, i zërit dhe kushtrimit nisi që kur ishte 14-vjeç, moshë që ndërmondet të jetë angazhuar në grupet ilegale të asokohëshme. Dy vjet e gjysmë studime në

Fakultetin e Filologjisë dhe rezultatet e shkëlqyera, e përcaktojnë qartë pritshmërinë e tij dijetuese. Më tej ai i hedh supeve të njoma barrën e rëndë të krijimit të një organizate social-demokrate, programin e së cilës e hartoi vetë. Prej këndeje i shkruhet me thëngjill të kuq fati i tij tragjik. Më 1961 arrestohet dhe dënohet me vdekje për agjitacion e propogandë. Pas një farë kohe, dënimi i zbret në 25 vjet burg. Si pasojë e aktivitetit të pas hekurave e nën zgjedhë, i shtohet dënimi edhe me dhjetë vjet për agjitacion e propagandë. Në gusht të vitit 1989 lirohet, duke mbajtur mbi vete 28 vite e gjysmë heqje lirie në burgjet famëkeqe të diktaturës. Merr pjesë që në fillimet e para të lëvizjes antikomuniste në Shkodër, e cila daton 25 vite të shkruara, më 14 janar 1990 kohë kur u shtri përdhe torsi prej betoni i diktatorit. Ajo kacafytje me komunizmin që përpëlitej në ago shënon shkënditë e para të flakadanit të lirisë në qytetin verior. Ishte në grupin themelues dhe zgjidhet kryetar i degës së PD-së për Shkodrën gjatë periudhës 1991-1992. Veprimtarinë e tij politike e pasuron besimi i vullnetit të sovranit, zgjedhja deputet në kohështrirjen 1991-2001, kulmim i së cilës është detyra e kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë, 6 prill 1992- 24 korrik 1997. Përgjatë gjithë kësaj periudhe Pjetër Arbnori dëshmoi vlerat më të epërme të një politikani bashkëkohor. Ai shquhej si rrallëkush për sensin e humorit dhe maturinë, tolerancën dhe urtësinë.

Nderet dhe vlerësimet - Përgjatë 71 viteve të jetës Pjetër Arbnori është nderuar me titujt “Mësues i Popullit”, “Pishtar i Demokracisë”, “Qytetar Nderi” i qytetit të Vaut të Dejës. Gjithashtu Asambleja parlamentare e vendeve frëngjishtfolëse, i ka akorduar titullin “Oficer i Madh i Urdhrit të Plejadës”. Presidenti i Republikës së Kosovës, Ibrahim Rugova, i ka dhënë medaljonin e argjend,

“Nënë Tereza” dhe prerjen e artë “Georgus Castriotus-Scanderbeg” 27.11.1996. Instituti Biografik i Kembrixhit dhe Instituti Biografik Amerikan kanë futur biografinë e Pjetër Arbnorit në “Who is Who” të intelektualëve dhe në Fjalorin Biografik Ndërkombëtar botimi 26-27. Ka marrë medaljen e shekullit XX për merita. Akademia Kulturorë Romë i ka dhënë medaljen “Scodrinon” dhe diplomën 2001. Me Urdhrin “Nderi i Kombit”, dekorohet (pas vdekjes) më 28.10.2011 nga Presidenti i Republikës Bamir Topi me motivacionin: “Personalitetit të shquar të Shkodrës dhe të gjithë Shqipërisë, simbolit të sakrificave mbinjerëzore nën persekutimin komunist, politikanit paqësor dhe shkrimtarit të talentuar, intelektualit vizionar e qytetarit fisnik, që gjithë jetën dhe veprimtarinë e tij ia kushtoi idealeve të mëdha të demokracisë, shtetit të së drejtës dhe të përparimit kombëtar”.

Galeria krijuese e Arbnorit shkrimtar - Profili i këtij personaliteti do të ishte i paplotë nëse nuk do të kumtohej krejt çfarë përbën galerinë e kreativitetit letra të Pjetër Arbnorit, të cilën megjithëse ai do ta rendiste si sekondare, pas politikës, mbetet më e qenësishmja verpimtari. Tharmin e atij shpirti krijues mëtohet për veçantinë e vet te ditari sekret, “Lufta për të mbetur njeri”, të cilin ka mundur ta mbajë larg flakëve të ferrit dhe makthit të qelive për 28 vite. Veprimtaria e botimeve e zgatur në kohërendjen 1992-2000 nis me “Kur dynden vikingët”, novelë, 1992, për të vazhduar me romanin “Mugujt e mesjetës”, 1993, novelën “Bukuroshja me hijen”, 1994, “E bardha dhe e zeza” roman, 1995, “E panjohura” – Vdekja e “Gebelsit” novela, 1996, “Shtëpia e mbetur përgjysmë”, roman 1997, për të cilin Pjetër Arbnori i’u shtuan dhjetë vjet burg. Kolanën e tij krijuese e pasurojnë: Romani “Vorbulla”, 1997, “Letër nga burg”, “Nga jeta në burgjet

komuniste”, studime historike 1992, “Brajtoni, një vetëtimë e largët”, roman 2000, “Lufta për të mbetur njeri” – intervista 1990-2000 dhe “Andre Morua, Historia e Anglisë”, përkthim 1996. Shtresohet më tej ky humus i përtëritjes së vlerave të letërsisë dhe kumtimit me “10300 ditë e netë në burgjet komuniste”, 2003, (botuar në shqip dhe në anglisht), “Martirët e rinj në Shqipëri – i nuovi Martiri in Albania”, 2004, (botuar në shqip dhe në italisht). – “Martirët në Shqipëri – The New Martyrs in Albania”, 2004, botuar në shqip dhe në anglisht). Për ta përmbyllur këtë punë vetëmohuese me përkthimet; Andrea Morua “Historia e Anglisë”, 1998, William Shirer “Ngritja dhe rënia e Rajhut të tretë” në dy vëllime, përkthyer në burg, në vitin 1988. Në ditën e lamtumirës, Dritëro Agolli shprehet se, vlera e Pjetër Arbnorit, i cili vuajti 28 vjet burg në kohën e diktaturës, qëndron në radhë të parë tek vlerat e tij njerëzore. Ndonëse me një jetë tejet të vështirë, ai nuk i maste kurrë njerëzit me metrin e përkatësisë partiake, por me vlerat e tyre njerëzore dhe morale. Pjetër Arbnori është shkrimtari dhe figura e mbijetesës së intelektualit në kohëra të vështira. Është vërtetë e pamundur të ndash figurën e tij si shkrimtar me atë të njeriut human dhe të butë. I tillë ishte dhe mbeti, atëditë e sot. Ne e kujtojmë dhe i shprehim mirënjohjen më të thellë për krejtçfarë ai bëri.

Epilogu - Sot e përkujtojnë të gjithë ata, tek të cilët mungesa e tashavitshme e këtij personaliteti ka lënë një bosh të thellë, por në veçanti bashkëshortja dhe dy fëmijët. Arbnori duke u rikthyer nëpërmjet kësaj “In memoriam” ysht në vetëdijen e politikës pendimin për harresën, me të cilën ata e ndëshkuan. Por emri dhe vepra e Pjetër Arbnorit do të mbetet e gjithmonshme në kujtesën e atyre që guxojnë edhe sot të besojnë në idealet, të cilave ai u dha me mish e me shpirt. *Marrë nga «360grade.al»*

Prof. Ulqini: “Toleranca fetare e shqiptarëve në zig-zaget e historisë”

Kohët e fundit nga Shtëpia Botuese “Fiorentina”, në Shkodër, doli një libër i ri, interesant e me vlerë, titulluar “Toleranca fetare e shqiptarëve në zig-zaget e historisë”, me autor Profesor Kahreman Ulqinin, një nga etnologët e historianët më të njohur të vendit. Libri pasqyron shkencërisht atë virtut të gjindes shqiptare, tolerancën fetare, që e nxiti Papën të zgjedhë për të shtegtuar për herë të parë në Evropë, trojet tona. Veprës së re të etnologut e historianit i prijnë dy citime tepër domethënëse. Së pari lexojmë fjalët e Abdyl Frashërit: “Në asnjë vend të botës nuk gjenden njerëz të besimeve të ndryshme, që të jetojnë në një miqësi dhe në një harmoni të tillë me atë që jetojnë shqiptarët myslimanë e të krishterë. Madje as në kohët e barbarisë më të thellë, kurrë nuk janë shënuar në Shqipëri grindje, luftëra, as masakra të shkaktuara nga dallime fetare”. Kjo, për traditën. Vjen pastaj citimi i shkëputur

nga vepra e Peter Burke, studiues i shquar bashkëkohor anglez, emri i të cilit lidhet edhe me vëllimin e UNESCO-s “Historia e njerëzimit” (1999), autor i më se 25 librave, gjë që flet vetë për metodën moderne shkencore, mbi të cilën u mbështet autori, për të trajtuar një temë kaq delikate, shumë herë të shpërdoruar për shkaqe nga më të ndryshmet e asnjë herë të thelluar me angazhim, vërtetësi e asnjësi të mirëfilltë shkencore. Ja edhe fjalët e Burkes: “...ideali për një historian mbetet që as të mos idealizojë, as të mos dënojë, por vetëm të përpiqet të kuptojë qëndrimet dhe vlerat e paraardhësve tanë”, ideal që i prin edhe Autorit të veprës. Sa i thjeshtë dhe i kuptueshëm për të gjithë, aq edhe i thellë e i shkruar me kritere të rrepta, për t’u folur dijetarëve – libri ka vlera të mirëfillta edukative e, jo më pak, edhe shkencore. Njerëzve të thjeshtë u jep një nga mësimet e mëdha të historisë: atë të tolerancës. Shkencës shqiptare

të etnologjisë e edhe asaj të historisë, shpesh të pavërtetë, i tërheq, me një asnjësi të admirueshme, vëmendjen që ta trajtojë me thellësi fenomenin. E kjo, në dobi të ardhmërisë paqësore - e sigurisht edhe të begatisë së shumëpremtuar, që deri më sot mbetet vetëm ëndërr e bukur - e përealizuar – e edhe e përealizueshme, pa tolerancën fetare. Kështu Profesor Kahreman Ulqini vë në dukje pikërisht ato vlera, që e tërhoqën vëmendjen e Papës Françesku për të vizituar Shqipërinë e për t’i theksuar që në fjalimin e tij të parë, atë të mirëseardhjes: “Ju përgëzoj posaçërisht për një karakteristike fatlume të Shqipërisë, që duhet ruajtur me shumë kujdes e vëmendje: e kam fjalën për bashkëjetesën paqësore dhe bashkëpunimin ndërmjet anëtarëve të feve të ndryshme. Klima e respektit dhe e besimit të ndërsjellë ndërmjet katolikëve, ortodoksëve e myslimanëve është

pasuri e çmueshme për vendin dhe fiton rëndësi të veçantë në kohën tonë, në të cilën grupet ekstremiste e shtrembërojnë kuptimin e vërtetë fetar dhe i përcudnojnë e instrumentalizojnë dallimet ndërmjet besimeve të ndryshme, duke i kthyer në faktorë të rrezikshëm përplasjeje e dhune, e jo në mundësi për dialog të hapur e të respektshëm, për përsiatje të përbashkët rreth domethënies që ka besimi në Hyjin e zbatimi i ligjit të tij”. Libri i Profesor Ulqinit, tejet aktual, e jo më pak, edhe interesant, larg çdo idealizimi, e studion shkencërisht këtë fenomen. Na siguron, kështu, se toleranca fetare në Shqipëri është realitet historik e se meriton të studiohet e të thellohet më tej edhe në ditët tona, madje në rang institucion... Duke u rikthyer tek vizita e Papës, kujtojmë edhe takimin me përfaqësuesit e feve të ndryshme, gjatë të cilit pati theksuar: “Liria e vërtetë fetare i shmanget tundimit të mostolerancës e të sektarizmit dhe mbështet qëndrimet e respektit

dhe të dialogut konstruktiv”. Nuk mund të mos e pranojmë se mungesa e tolerancës ndaj atij që ka bindje fetare të ndryshme nga tonat është armik posaçërisht tinëzar, që sot, fatkeqësisht, po shfaqet në rajone të ndryshme të botës. Si besimtarë, duhet të jemi veçanërisht syhapur, që shpirti fetar dhe etika, të jetuara me bindje dhe të dëshmuara me pasion, të shprehën gjithmonë me sjellje të denja për misterin që duan të nderojnë, duke i përjashtuar me vendosmëri si të pavërteta, sepse të padenja për Hyjin e për njeriun, të gjitha ato forma që përfaqësojnë përdorimin e shtrembër të fesë. Vepra e re pasurohet, konkretizohet e bëhet edhe më e këndshme në të lexuar, falë 18 shtojcave, që e përmbyllin e që e nxisin lexuesin t’i shfletojë me një frymë. Zgjedhëm ndonjë prej tyre, për ta lexuar në Radion tonë, pas paraqitjes së veprës “Toleranca fetare e shqiptarëve në zig-zaget e historisë”. Do të mund t’i ndiqni që në emisionet e ardhshme.



EUROSIG

SIGURI E STANDARDEVE EUROPIANE

Adresa: Rr. "Papa Gjon Pali II-te, vila nr 5, Tirane, Shqiperi, Kutia Postare nr 126
Tel: (+355) 4 238 899/999, Fax: (+355) 4 223 841
www.eurosig.al, email: info@eurosig.al

- SIGURIM I AUTOMJETEVE
- SIGURIM KASKO DHE PAJISJE ME GPS
- SIGURIM NGA SEMUNDJET E AKSIDENTET
- SIGURIM I BIZNESIT
- SIGURIM I SHENDETIT NE UDHETIM
- SIGURIM I AKSIDENTEVE NE PUNE
- SIGURIM I GARANCIVE
- SIGURIM NGA ZJARRI DHE FATKEQESITE NATYRORE
- SIGURIM I MALLIT NE TRANSPORT
- SIGURIM I PERGJEGJESIVE
- SIGURIM I NXENESVE E STUDENTEVE
- SIGURIM I BANESES





Ka filluar fushata e abonimeve në gazetën "55". Ofertat e abonimeve jane:

1 muaj	900 lekë
3 muaj	2700 lekë
6 muaj	5400 lekë
1 vit	10800 lekë

Të gjithë të interesuarit që duan të abonohen në gazetën "55", të drejtohen pranë:

POSTA SHQIPTARE
AGJENSIA E SHPERNDARJES E SHTYPIT 1,2
ADRION LTD
TEL: 04/2321364 | CEL: 069 20 99 794



Ylli: Ftojme të gjithë punonjësit të na njoftojnë dhe denoncojnë çdo shkelje që do ju bëhet në kundërshtim me të drejtat që atyre jua garanton ligji dhe do jemi shumë serioz në trajtimin e tyre

Shëngjin, Inspektoriati i Punës takim me sipërmarrje private në fushën e Hoteleri-Turizëm


Drejtori i Inspektoriatit, Dritan Ylli: Çdo punëdhënës para fillimit të aktivitetit ka detyrim deklarimin e tij dhe deklarimin e çdo punëmarrësi para fillimit të punës "Për punësimin e punëmarrësit nën 18 vjeç, kërkohet Autorizim i posaçëm, i lëshuar nga Inspektorati Punës, ku të lejohet punësimi i tij"

Inspektoriati Shtetëror i Punës, zhvilloi një takim me përfaqësues të sipërmarrjes private në fushën e Hoteleri-Turizëm, në bregdetin e Shëngjinit. Në këtë takim ishin të pranishëm, Drejtori i Inspektoriatit z.Dritan Ylli dhe drejtues të tjerë të këtij institucioni, si dhe përfaqësues kryesorë të kompanive private që ofrojnë mundësi për akomodimin dhe shërbimin për turistët. Duke qenë se, bregdeti shqiptar në tërësi, me zhvillimin sezonal të turizmit, kthehet në një punëdhënës kryesor të vendit tonë, qëllimi i këtij takimi ishte informimi dhe bashkëbisedimi me përfaqësuesit e bizneseve për të garantuar që punësimi të bëhet sipas standardeve që përmban ligji. Ndërkaq përpara fillimit të takimit me përfaqësuesit e biznesit, drejtori i Inspektoriatit Dritan Ylli takoi dhe bashkëbisedoi me punonjësit të ndryshëm të hoteleve dhe restoranteve në Shëngjin. Ai i pyeti ata mbi kushtet e punës dhe trajtimin e tyre konform Kodit të Punës dhe legjislacionit të punës në tërësi. Në fjalën e tij drejtori i Inspektoriatit të Punës, z.Dritan Ylli me përfaqësues të biznesit hotelieri-turizëm në Shëngjin tha se: "Kam kënaqësinë ta takohem sot dhe të bashkëbisedoj me ju përfaqësuesit kryesorë të sipërmarrjes private në bregdetin kaq të bukur të Shëngjinit, duke qenë se ju dhe shumë sipërmarrje të tjera në gjithë vijën bregdetare të Shqipërisë, në sezonin veror jeni punëdhënës më i rëndësishëm në vendin tonë. Ndaj për ne është shumë e rëndësishme, në radhë të parë që ju krijoni kushtet



dhe standardet që qindra dhe mijëra turistë shqiptarë apo të huaj, të pushojnë në mënyrë komode në bregdetin tonë të mrekullueshëm, por për më tepër rrjedhimisht krijoni mundësinë e punësimit për qindra mijëra qytetarë shqiptarë. Ne jemi këtu për të kërkuar nga ju, për t'ju informuar dhe bashkëbiseduar me ju, që këto punësime, të bëhen sipas standardeve ligjore të punësimit. Ky takim është një mundësi informimi dhe këshillimi për të gjithë ju punëdhënës, për zbatimin e kërkesave ligjore që rregullojnë marrëdhënien e punësimit. Gjatë kontrolleve dhe monitorimeve tona në të gjithë vendin, në vitet e mëparshme, punësimi gjatë sezonit turistik, ka nxjerrë në pah një sërë problematikash shqetësuese. Konkretisht këta problematika kanë qenë në drejtim të informalitetit të punësimit, në punësimin e të rinjve nën moshën 18 vjeç, punës me orë të tejkzgjatura, punës në ditët e pushimit javor, punës gjatë natës, punësimit me kohë të pjesshme, etj". Në vijim të fjalës së tij z.Ylli shtoi se: "Të gjitha këta kanë evidentuar shkelje në marrëdhënien e punësimit, duke cenuar dhe të drejtën e qytetarëve

për të pasur kushte pune, siç e përmbajnë dhe standardet e legjislacionit të punës në Shqipëri. **Po çfarë duhet të mbahet parasysh nga punëdhënësit në respekt të dispozitave ligjore?** Çdo punëdhënës para fillimit të aktivitetit ka detyrim për deklarim të tij, si dhe detyrim për deklarimin e çdo punëmarrësi para fillimit të punës. Për punësimin e punëmarrësit nën 18 vjeç, kërkohet Autorizim i posaçëm, i lëshuar nga Inspektorati Punës, ku të lejohet punësimi i tij. Për të marrë, këtë autorizim duhet; kërkesë me shkrim nga punëdhënësi pranë Degës së Inspektoriatit të Punës sipas qarkut përkatës, ku jepet të dhëna, si gjeneralitetet e punëmarrësit/ve, koha gjatë së cilës do të punojë, vendi dhe procesi i punës që do të kryejë si dhe ekzaminimin mjekësor. Pas verifikimit nga inspektori i punës lëshohet ky autorizim. Inspektorët e punës lejojnë punësimin për punëmarrësit nën 18 vjeç, kur plotësohen këto kushte. Nga moshë 14 - 16 vjeç lejojnë të punojnë vetëm gjatë pushimeve shkollorë, në punë të lehta që nuk i shkaktojnë dëm sigurisë, shëndetit dhe zhvillimit



të të miturit. Nga ana jonë, si Inspektoriati i Punës, duke qenë se flasim për një sezon të ngjeshur, janë dhënë të gjitha udhëzimet Degëve Rajonale në Qarqe për moskrijimin e pengesave artificiale, burokratike për përfaqësuesit e bizneseve. Përkundrazi të krijojnë të gjithë lehtësirat e mundshme, që nga deklarimi i punonjësve e deri tek lëshimi i shpejtë dhe pa vonesa të pajustificueshme të autorizimeve për punësimin e të miturve nën 18 vjeç". "Punëmarrësit duhet të tregohen të kujdesshëm, që të mos i mbajnë punonjësit jashtë kohës normale të punës, apo më keq akoma duke i rraskapitur punonjësit në orare të tejkzgjatura, pasi kjo në radhë të parë shkakton lodhje dhe dëmtim të shëndetit të tyre dhe nga ana tjetër ata nuk do kenë rendimentin dhe cilësinë e duhur të shërbimit të tyre. Koha e plotë e punës apo koha e pjesshme e saj të përcaktohet dhe të respektohet në kontratat individuale të punës të lidhura me çdo punëmarrës. Asnjë punëmarrës, nuk duhet të fillojë punë pa pasur një kontratë të detajuar pune, nga e cila derivojnë të gjithë të drejtat që i takojnë një qytetari në marrëdhënie pune.

Ne dëshirojmë që këto standarde të merren në konsideratë nga të gjithë ju, pasi ne synojmë qëllimin e përbashkët, krijimin e kushteve sa më të mira për turistët, zhvillimin e një biznesi të suksesshëm nga të gjithë ju dhe sigurisht trajtimin me dinjitet të punonjësve dhe nuk është synimi ynë sanksioni apo penalizimi i asnjë subjekti. Por në rast të shkeljes së të drejtave të punonjësve apo trajtimit skllavërues të tyre penaltetit dhe sanksioni do te jete i ashpër. Së fundmi; Zyrat e Inspektoriatit të Punës, në qarqe do të jenë të hapura dhe për çdo informacion, që do t'ju duhet jeni të lutur të drejtoheni dhe të informohemi. Ne ftojme të gjithë punonjësit të na njoftojnë dhe denoncojnë çdo shkelje që do ju bëhet në kundërshtim me të drejtat që atyre jua garanton ligji dhe do jemi shumë serioz në trajtimin e tyre. Nga ana tjetër, duhet te ju garantoj si gjithnjë, se do të jemi gjithnjë të hapur dhe presim çdo denoncim, nga përfaqësuesit e biznesit, në rast të ndonjë sjellje joetike, joprofesionale dhe në kundërshtim të ligjit nga inspektorët e punës" – përfundon fjalën e tij drejtori i Inspektoriatit Shtetëror të Punës Dritan Ylli.

Bashkia e Tiranës rriti taksat, bizneset përcjellin rritjen e tarifave tek qytetarët

Taksat indirekte reflektohen te çmimet, inflacioni i qershorit u rrit në 1.2 %

Rritja e taksave, veçanërisht atyre të Bashkisë ka filluar të përcillet tek qytetarët përmes shtrenjtimit të çmimeve për disa artikuj bazë. Instituti i Statistikave njoftoi pas një rënie afër zeros në muajt e parë të 2016, niveli i përgjithshëm i çmimeve ka nisur të rritet në muajin qershor, duke arritur në 1.2 %. Përveç veshjeve dhe komunikimit të gjitha grupet e tjera të mallrave kanë shënuar rritje vjetore duke reflektuar kështu rritjen e taksave dhe kostove për industri të veçanta. Rritja e taksave bashkiake në Tiranë dhe rritja e kostove të biznesit në tërësi, sidomos nga mbifaturimi i energjisë

elektrike me tre lekë, duket se është transferuar në çmime. Sipas INSTAT rritja vjetore në muajin Qershor është ndikuar kryesisht nga grupi "Ushqime dhe pije joalkoolike" me +0,97 pikë përqindje. Çmimet e grupit "Shërbimi arsimor" kanë kontribuar me +0,19 pikë përqindje. Çmimet e grupit "Pije alkoolike dhe duhan" kanë kontribuar me +0,07 pikë përqindje. Çmimet e grupit "Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë" kanë kontribuar me +0,06 pikë përqindje. Çmimet e grupit "Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji" dhe "Argëtim dhe kulturë" kanë kontribuar secili

me nga +0,04 pikë përqindje. Çmimet e grupit "Hotele, kafene e restorante" kanë kontribuar me 0,03 pikë përqindje dhe çmimet e grupit "Shëndeti" kanë kontribuar me 0,02 pikë përqindje. Çmimet e grupit "Transporti" kanë kontribuar me -0,23 pikë përqindje. Çmimet e grupit "Veshje dhe këpucë" kanë kontribuar me -0,06 pikë përqindje dhe çmimet e grupit "Komunikimi" kanë kontribuar me -0,03 pikë përqindje. Krahasuar me muajin Qershor 2015, rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin "Shërbimi arsimor" me 4,8 % pasuar nga grupi, "Ushqime dhe pije joalkoolike" me 2,7

Fig. 2 Ndikimi i grupeve në ndryshimin vjetor



%, grupi "Argëtim e kulturë" me 1,6 %, grupi "Pije alkoolike dhe duhan" me 1,4 %. Brenda grupit të ushqimeve çmimet e nëngrupit "fruta" u rritën me 16,3 %, pasuar nga nëngrupi "zarzavate përfshirë patatet" me 7,1 %, nëngrupi "qumësht, djathë e vezë" me 2,7 %, nëngrupi "sheqer, reçelra e ëmbëlsira" me 2,1 %. Çmimet e nëngrupeve "bukë e drithëra" dhe "mish" u ulën me nga 1,0 %. Ndërsa,

ulja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin "Transport" me 3,6 %, pasuar nga grupet "Veshje dhe këpucë" me 1,5 %, grupi "komunikimi" me 1,0 %. Krahasuar me muajin Maj 2016, ulja më e madhe mujore e çmimeve vërehet në grupin "Ushqime dhe pije alkoolike" me 1,9%. Brenda grupit të ushqimeve ulja më e madhe e çmimeve vërehet në nëngrupin "zarzavate përfshirë patatet" me 8,9 %.

Mbledhja e KLD, betohen 9 magjistratët e rinj dekretuar në detyrën e gjyqtarit

Këshilli i Lartë i Drejtësisë, zhvilloi dje, mbledhjen plenare, e cila nisi me ceremoninë e betimit të 9 (nëntë) magjistratëve që përfunduan Shkollën e Magjistraturës në vitin akademik 2014-2015, të dekretuar nga Presidenti i Republikës, Bujar Nishani, në detyrën e gjyqtarit, bazuar në propozimin e bërë nga KLD. Pas leximit të formulës së betimit: "Betohem solemnisht se gjatë kryerjes së detyrës do të respektoj Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ligjet në fuqi dhe do të respektoj rregullat e etikës profesionale. Betohem", në praninë e anëtarëve të KLD-së, gjyqtarët më të rinj të sistemit u betuan sipas procedurës ligjore. Betimi mbi Kushtetutë u bë nga gjyqtarët: Znj. Matilda Fetau, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan; z. Besmir Stroka, në Gjykatën e Rrethit

Gjyqësor Shkodër; znj. Ina Hoxhaj, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec; znj. Armela Hasantari, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë; z. Paulin Çera, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës; znj. Esmerilda Habili, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë; z. Gentian Marku, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë; znj. Nertila Kape, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër; znj. Yrfet Shkreli, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet. Mbledhja vijoi me shqyrtimin dhe miratimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, për vënien në ekzekutim të vendimit penal nr. 156 akti, datë 29.06.2016 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, dhënë ndaj shtetasit Sh.Ç., gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat, si i dyshuar për kryerjen

e veprës penale të "Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë", parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal, në kuadër të procedimit penal nr. 152/2015. Pas diskutimeve, Këshilli vendosi pezullimin nga detyra, të gjyqtarit Sh.Ç., deri në marrjen e vendimit gjyqësor të formës së prerë për çështjen penale në ngarkim të tij. Bazuar në përcaktimet e rendit të ditës, Këshilli shqyrtoi projekt-aktet përfundimtare të vlerësimit, të Kryeinspektorit të Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë Nr. 261/2, datë 14.04.2010 "Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve". Në përfundim, anëtarët miratuan aktet e Vlerësimit për gjyqtarët e mëposhtëm: Gjyqtar Jak Ndoka, Gjykatë e Rrethit Gjyqësor Lezhë; Gjyqtar Granit Qypi,



Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës; Gjyqtar Bledar Abdullai, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë; Gjyqtar Artur Kalaja, Gjykata e Apelit Tiranë; Gjyqtar Martin Deda, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë; Gjyqtar Fatri Islamaj, Gjykata e Rrethit

Gjyqësor Tiranë. Si pikë të fundit të rendit të ditës, Këshilli vendosi delegimin e disa gjyqtarëve në shqyrtimin e çështjeve të caktuara gjyqësore, në gjykata të tjera nga ku ata janë emëruar për të ushtruar funksionin e gjyqtarit.

Operacioni antidrogë "Ballkan" në katër shtete, arrestohen 30 shtetas, 14 shqiptarë

Asete me vlerë 10 milionë euro, sekuestrohen pallatet e ndërtuesve që bënin trafik droge

Biznesmenët e ndërtimit/Si drejtohej skema e trafikut të drogës. Në bazë të hetimeve të Policisë dhe Prokurorisë së Krimeve të Rënda rezultojnë se, shtetasit Jurgen Molla, Shyqyr Kotorri dhe Nuredin Nazëraj, kanë pasur rolin e financuesit dhe të organizatorit të këtij aktiviteti për sigurimin e trafikimit të drogës nga Turqia në drejtim të Shqipërisë, për llogari të interesave të grupeve kriminale, që operojnë brenda dhe jashtë vendit

Në Gjykatën e Krimeve të Rënda u zhvillua dje seanca për verifikimin e masës së sigurisë ndaj 7 të arrestuarve ditën e djeshme të dyshuar si pjesëtarë të një grupi trafik droge. Ata u njohën me masën "arrest me burg". Sakaq, mësohet se Prokuroria e Krimeve të Rënda do të vendosë nën sekuestro pallatet e ndërtuara nga firma "Molla Shpk" në zonën e Yzberishtit. Sipas burimeve të prokurorisë, për të shmangur një problem social ndaj qytetarëve që kanë blerë apartamente tek kjo firmë po diskutohet mundësia që të vendosen nën sekuestro shumat e paguara nga shtetasit për këto blerje, raporton "TCH". Krimet e Rënda shpjegojnë në rrugë jozyrtare se vlera e këtyre aseteve të dyshimta, për të cilat shihet si burim trafikimi i drogës, arrijnë në 10 milionë euro. Ndërkohë, nën hetim pasuror do të vendosen të gjitha pasuritë e të arrestuarve. Prokuroria pohon se nga hetimi i këtij rrjeti, që prej vitit 2015 janë identifikuar tre episode të trafikut të drogës, në të cilin kërret e organizatës pasi kanë kryer takime për ngarkesat e heroinës dhe hashashit kanë dërguar si garanci me njerëz të besuar edhe shuma të konsiderueshme prej 230 mijë eurosh. Kryeprokurori i Krimeve të Rënda, Besim Hajdarmataj, i pranishëm në konferencën për shtyp, ku u pasqyruan rezultatet e operacionit antidrogë "Ballkan", tha se aktualisht ka nisur edhe hetimi pasuror për të arrestuarit. Sipas tij, në zbatim

të ligjit "Antimafia", krahas dokumentimit të veprimtarisë kriminale të trafikut të drogës, kanë nisur edhe veprimet për aplikimin e masave parandaluese ndaj pasurisë. Prokurori Eugen Beçi në zbatim të ligjit "Antimafia" do të sekuestrojë të gjitha pronat që figurojnë në emër të tre ndërtuesve tashmë të arrestuar si financues të rrjetit të trafikut të drogës. Burimet thonë është kërkuar nga Hipotekat, bankat e nivelit të dytë dhe Qendra e Regjistrimit të Bizneseve të evidentojnë pronat dhe pasuritë e tre ndërtuesve Jurgen Molla, Shyqyr Kotorri dhe Anesti Koromani, tashmë të arrestuar. Sipas akuzës, të tre ndërtuesit nga verifikimet parapake rezultojnë pronar të disa pallateve dhe komplekseve të ndërtuara në zonën e Kasharit, Yzberishtit, Unazën e madh dhe në Dajt. Të gjithë këto pronat do të sekuestronin pasi dyshohet se janë ndërtuar me paratë e ardhura nga trafikimi i drogës. Nga sekuestrimi, thonë prokurorët do të shpëtojnë vetëm ata apartamente që janë blerë nga qytetarë të ndryshëm dhe që disponojnë një kontratë premtimi apo blerje. Këto kontrata do të verifikohen dhe për të mos shkaktuar një problem social, hetuesit thonë se ato apartamente nuk do të



financues dhe blerës. Në bazë të hetimeve të Policisë dhe Prokurorisë së Krimeve të Rënda rezultojnë se, shtetasit Jurgen Molla, Shyqyr Kotorri dhe Nuredin Nazëraj, kanë patur rolin e financuesit dhe të organizatorit të këtij aktiviteti për sigurimin e trafikimit të drogës nga Turqia në drejtim të Shqipërisë, për llogari të interesave të grupeve kriminale, që operojnë brenda dhe jashtë vendit. Në rolin e ndërmjetësuesit janë identifikuar shtetasit, Arben Prendi dhe Blerim Ukimeraj, ndërsa në rolin e blerësit dhe financuesit ishin të përfshirë Romeo Beqa, Viktor Behaj, Anesti Koromani, Denis Sinameta (Land Lleshi), Lulzim Qorri, Gjolek Xhaferi, Robert Petoshati, Myqerem Çela, Fatos Muçi. Sipas Prokurorisë dhe Policisë, ky grup i financuesit paratë në fushën e ndërtimit. Jurgen Molla është bashkëpronar në firmën e ndërtimit "Molla shpk", nën emrin e së cilës është ndërtuar një kompleks pallatesh në zonën midis Yzberishtit dhe Kasharit. Ky shtetas rezultoi nga hetimi se ka pasur në përdorim vazhdimisht mjete luksoze, si automjete tip foristradë "Porch Cayen", "Audi A6", BMË X6 etj. Dyshohet se në bashkëpunim me shtetas të tjerë janë marrë me kontrabandë naftë dhe trafikim motorike gjatë viteve të embargos së naftës,

bllokohen por vetëm pjesa e pashitur e këtyre ndërtimeve. Nga ana tjetër, paratë që tre ndërtuesit disponojnë në llogaritë e tyre bankare dhe pjesëtarëve të familjes do të sekuestronin deri në një vendim tjetër. Sekuestrimit nuk do të shpëtojë edhe hoteli i njohur në zonën e Vlorës i shtetasit Nuredin Nazëraj. Gjithashtu në sitën e ligjit antimafia do të kalojnë edhe pronat e pasuritë e të arrestuarve Lulzim Qorri dhe Denis Sinameta. **Si drejtohej skema e trafikut** 14 shtetasit shqiptar, të arrestuar në operacionin ndërkombëtar të drogës, me emrin e koduar "Ballkan", funksiononin në skemë piramidale të një grupi të strukturuar kriminal, me organizatorë, ndërmjetësues,

ndaj ish – Federatës Jugosllave, në bashkëpunim me shtetas të tjerë. Në vitin 2009 ka filluar të merren me ndërtimin e pallateve, fillimisht në qytetin e Lezhës. Pas vitit 2010, vëllezërit Molla janë shpërngulur në Tiranë, ku kanë filluar ndërtimin e një blloku pallatesh në zonën e Kasharit. Dyshohet se kanë investuar në fushën e ndërtimeve mbi 10 milionë euro. Shtetasi Anesti Koromani dyshohet se ka investuar para në pallatet që ndërton firma "Molla Sh.p.k". Shyqyr Kotorri është vëllai i Hikmet Kotorrit i vrarë në vitin 2013. Ka firmë ndërtimi "Kotorri-SL shpk" dhe "Hapësira X". Shtetasi Shyqyr Kotorri ka qenë në kërkim nga drejtësia greke, për vepra penale në fushën e trafikimit të lëndëve narkotike dhe të krimit të organizuar. Ka investuar në ndërtim mbi 6 milionë euro, kryesisht pallate të ndërtuara në rrugën e Elbasanit. Ka dyshime se po ndërton edhe në zonën e Freskut. Paratë dyshohet se i ka përfutur kryesisht nga trafikimi i lëndëve narkotike. Nuredin Nazëraj është i njohur në fushën e trafikimit të lëndëve narkotike. Ka qenë dhe më parë i arrestuar për këtë veprë penale. Në vitin 2014, djali i tij ka kryer një vrasje në Vlorë për motive të dobëta. Është pronar i Hotel Delfini në Vlorë. Hetimet zbuluan se aktiviteti i këtij grupi kriminal, me 30 të arrestuar e 25 persona të shpallur në kërkim, e ushtronte veprimtarinë e tij në Shqipëri, Maqedoni, Greqi, Bullgari e Kosovë.

Ngjarjet e datave 3-10 korrik 1990 në Kavajë

Raporti zyrtar mbi ngjarjen mbi “operacionin e spastrimit”

Nga Kastriot Dervishi

Paralelisht me ngjarjet e ambasadave në Tiranë, u zhvilluan disa ngjarje të tjera në Kavajë. Në qytetin ku lëvizja antikomuniste kishte shtratin e vet të natyrshëm. Demonstrata antikomuniste e 26 marsit 1990 u pasua nga ajo e 3 korrikut të këtij viti. Për këtë arsye demonstrimi antikomunist në Kavajë, përfshi jehonën edhe në radiot ndërkombëtare, ku më i njohuri ishte ai i “Zërit të Amerikës”, u bë shqetësues për regjimit. Në Kavajë u dërguan forca speciale të cilat nisën veprime të dhunshme ndaj qytetarëve. Ndoshta duket si e çuditshme por në atë kohë, forcat speciale kërjt pa arsye rrëmbenin djem të rinj nëpër rrugët e Kavajës, i qethnin zero, i rrihnin e pastaj i lëshonin. Kjo lloj sjelljeje e kishte bërë gjendjen në Kavajë midis data 3 – 10 korrik shumë të acaruar. Nëpër qytet vareshin shumë të rinj të qethur të cilët kishin marrë në një farë mënyre “damkën” se ishin “armiqtë partisë”.

Duke shtuar edhe faktin se në Tiranë po zhvilloheshin ngjarjet e ambasadave, situata në Kavajë përballë një qyteti antikomunist nuk mund të kontrollohej në asnjë rrethanë. Nervozizmi që kishte rrëmbyer regjimin ishte i madh. Kjo për një fakt të thjeshtë: nuk mund të vinte nën kontroll situatën. Për këtë arsye, ai përpigje që atë që po ndodhte në Kavajë përcillte pikësëpari si çështje rendi publik. Kulmi i ngjarjeve të Kavajës ishte vrasja e Josif Bodos. Më poshtë do të përcjellim dokumentacionin e kohës, atë të Hetuesisë së Përgjithshme, një organ në varësi të Kuvendit Popullor, i cili sot nuk ekziston. Në këtë material vihet re edhe gjuha zyrtare e regjimit i cili është munduar që këto ngjarje t'i artikulojë si të bëra nga “vagabondë e rrugaçë”, etj.

Republika Popullore
Socialiste e Shqipërisë
Hetuesia e Përgjithshme



*Hetuesia e Rrethit
Durrës, 14.7.1990*

*Lënda: Mbi ngjarjen e
ndodhur më 10.7.1990*

Më 10.7.1990 organet e policisë së rrethit të Durrës në bashkëpunim me repartin 326 të policisë së Tiranës, do të kryenin në qytetin e Kavajës veprime spastrimi (krehje siç e quajnë ata) ndaj elementëve vagabondë e huliganë që kishin shkaktuar trazirat e datës 4.7.1990 në këtë qytet. Gjatë datë 10.7.1990 forcat e policisë kanë vepruar në qytetin e Kavajës dhe në plazhin e Golemit dhe në mbrëmje të kësaj date rreth orës 21.00, ka ndodhur



përlëshje deri në përdorimin e armës, midis forcave të policisë dhe qytetarëve të qytetit ku gjeti vdekjen nga goditja me armë shtetasi Josif Budo, me moshë 21 vjeç, si dhe është plagosur edhe i vëllai i tij po me armë. Nga hetimet e kryera deri tani për këtë ngjarje është vërtetuar se veprimet e repartit të policisë, sidomos të sampistëve të ardhur nga Tirana, kanë qenë brutale dhe të kundërligjshme. Janë marrë 40 të rinj të moshave 15-19 vjeç, shumica të pafajshëm dhe janë dërguar në policinë e Durrësit, duke i rrahur me shkopinj gome e duke i qethur me forcë. Gjithashtu, gjatë kryerjes së

këtyre veprimeve, kanë fyer dhe rrahur mjaft qytetarë krejtësisht të pafajshëm që kanë gjetur në rrugë, lokale, ose vendshplodhje. Në këto veprime ka patur shembuj të përdorimit të dhunës edhe ndaj moshave të thyera si është p.sh. rasti i Servete Llullës me moshë 58 vjeçe, e cila u godit me shkop gome pa asnjë arsye dhe me makinë u dërgua në Durrës forcërisht. Këtu i kanë lënë edhe një polic për ta ruajtur sepse gjoja ka qenë pjesëtare në demonstratë. Në fakt kjo qytetare është nga një familje shumë të mirë, nga të heroit të punës socialiste Nustret Llulla. Këto veprime në tërësi indinjuan jo vetëm

të afërmit e personave, ndaj të cilëve u ushtrua dhuna, por edhe shumë qytetarë të thjeshtë, komunistë e njerëz të ndershëm, që i kanë parë këto veprime. Në përleshjen e ndodhur në orën 21.00 nga forcat e policisë janë përdorur qitjet me pistoletë dhe është vrarë dhe plagosur me armë qytetarët e mësipërm. Nga ana tjetër, populli i revoltuar ka goditur me gurë e tulla forcat e policisë dhe një masë e mase, prej 6-7 mijë vetash të mbështetur edhe nga disa mijëra të tjerë kanë dalë më 11.7.1990 për në varrimin e të vrarit ku gjatë rrugës kanë hedhur parulla të shumta si "duam gjak, hakmarrje, liri-demokraci, poshtë pushteti, po bëhet si te serbi e në Kili", etj, parulla kundër udhëheqjes kryesore të partisë. Pas varrimit kanë sulmuar me gurë ndërtesën e policisë dhe të Komitetit të Partisë së Kavajës ku kanë thyer të gjitha xhamat e ndërtesës së Komitetit e të automjeteve dhe të gjithë njësitë të shërbimit në dy anët e rrugës, ndërsa mjetin e sekretarit të parë të rajonit e kanë djegur. Këto veprime janë kryer nga një masë e veçuar të rinjsh, kryesisht nga ata të moshës 12-13 dhe deri 17 vjeç, të mbështetur me brohoritje nga pas nga turma e njerëzve. Gjatë kryerjes së këtyre veprimeve, nga ana e popullit janë hedhur dhe përkrahur në formë kori parullat e mësipërme. Nga ana e organit të hetuesisë, u kryen të gjitha veprimet e mundshme hetimore, por kur u shkuan me grup hetimor për të këqyruar vendin e ngjarjes dhe kufomën, nga familjarët dhe masa e popullit në lagje nuk u lejua të kryhej asnjë veprim dhe përkundrazi shokët e grupit të hetimit janë fyer, kërcënuar rëndë dhe përzënë nga vendi i ngjarjes, duke u thënë: "ikni se ju jeni të poshtë, do t'i mbulonim fajet e atyre që kanë qëlluar mbi popullin e pafajshëm, të atyre që kanë urdhëruar. Ju vrate një, do të vrisni edhe të tjerë, por populli i Kavajës ka djem shumë, le të vejë gjaku deri në gju", etj. Për pasojë, me gjithë kërkesën vonë disa herë, akoma nuk është bërë këqyrja e vendit të ngjarjes, ndërsa viktima është varrosur pa iu nënshtruar autopsisë dhe ekspertizës mjeko-ligjore. Në vendin e ngjarjes thuhet se kanë mbetur plumbat në murin ku është vrarë Josif Budo, por ato nuk janë marrë akoma për shkaqet që u thanë

më lart. Ndërsa gëzhojat e fishekëve të qitjes gjatë ngjarjes, janë marrë nga familjarët e viktimës dhe deri tani janë dorëzuar 7 copë. Ato janë të gjitha fishekë pistolete dhe vazhdon eksperimentimi kriminalistik. Gjatë ngjarjes së datës 10.7.1990 rezultoi të jetë bërë qitje gjatë përleshjes, si nga policët edhe nga sambistët, por identifikimi i personave që kanë qëlluar akoma nuk është bërë. Nga hetimi i kryer deri tani, rezultoi që viktima Josif Budo dhe vëllai i tij, janë vrarë dhe plagosur nga sambistët, por se cili ka qenë autori i qitjes mbi ta ende nuk është vërtetuar. Mendojmë se shkak kryesor për ndodhjen e kësaj ngjarjeje, janë veprimet e nxituara të policisë dhe sidomos të sambistëve që irrituan popullin me sjelljet dhe veprimet e tyre brutale dhe të kundërligjshme. Këtë situatë mendojmë se e ka shfrytëzuar reaksioni dhe elementi armik për të nxitur dhe masivizuar popullin me veprimet e tyre kundër organeve të partisë dhe pushtetit në qyteti. Gjithashtu për opinionin e Kavajës, futja e tankeve dhe forcave ushtarake në qytet, pas kësaj ngjarjeje, është e papranueshme dhe fyese, duke shprehur që "me tanke do të frikësoni popullin". Në takimin që bëme më 13.7.1990, me dajën e viktimës Telemak Stefa na dorëzoi 5 gëzhoja të gjetura në vendngjarje dhe njëkohësisht kërkoi që hetimet të bëhen me drejtësi për shkaktarët e këtyre ngjarjeve e njëkohësisht u shpreh që për gjendjen në Kavajë do të informohet udhëheqësi kryesor i partisë. Theksojmë se në vendin ku është vrarë shtetasi Vasil Budo (Josif Budo - shënim), nga të rinjtë të Kavajës është rrethuar me gurë, vazhdimisht hidhen lule, si natën dhe ditën bëjnë roje të rinjtë të shumtë që nuk lënë aty të afrohet asnjëri. Mendimi ynë është se gjendja në Kavajë është tepër serioze, por me probleme të shumta dhe të komplikuar që kanë ardhur vazhdimisht duke bërë të mprehta dhe zgjidhja e tyre duhet të bëhet me një punë të madhe të partisë. Lënia në këtë gjendje mund të sjellë pasojë shumë të rënda për punën e partisë.

Kryetari i Hetuesisë së Rrethit
Bashkim Asllani
(Vijon numrin e ardhshëm)



Intervistë me z. Marius Dobresku, përkthyesin e letërsisë shqipe në Rumani

Nga Flori Slatina

Përkthyesi dhe shkrimtari rumun, Marius Dobresku, një emër i njohur tashmë për letërsinë shqipe, pasi është zëri i tij që u bën jehonë veprave shqipe në Rumani. Ai ka një kontribut të jashtëzakonshëm për njohjen e kulturës shqipe në Rumani, me botimet e panumërta për Shqipërinë dhe kulturën shqiptare, në një hark kohor për afro katër dekada. E në krye të këtyre veprave, si kudo në botë, qëndron vepra e të madhit Ismail Kadare, duke qenë se e lexojnë Kadarenë në gjuhën rumune, falë përkthyesit të mbi 30 romaneve të Ismail Kadaresë, Marius Dobrescu-t. Përkthyesi i shquar dhe miku i madh i shqiptarëve, Marius Dobrescu, meriton nderimin e shqiptarëve për këtë vepër me vlera, për gjithë veprimtarinë e tij në të mirë të afirmimit të shqiptarëve dhe Shqipërisë në botë. Marius Dobresku është cilësuar si ambasadori i Kulturës Shqiptare në Rumani e në mbarë rajonin. Ai është autor i shumë artikujve publicistikë, që i dedikohen Shqipërisë në shtypin rumun, por mbi të gjitha është një nga përkthyesit më të mirë të veprave shqiptare në gjuhën rumune. Dobresku është vlerësuar edhe me çmime kombëtare në Rumani duke u shpallur "përkthyesi më i mirë i vitit", për përkthimin e veprave të Kadaresë, por dhe laureati i çmimit "Penda e argjendte" (Tiranë 2006). Së fundi ai u vlerësua në Korçë me "Emblemën e Artë të qytetit". Marius Dobresku u lind në Braila në vitin 1951. Ai mbaroi studimet për Gjuhë dhe Letërsi Shqipe në Universitetin e Tiranës. Punoi si drejtor i Bibliotekës Kombëtare të Rumanisë e më pas iu dedikua gazetarisë. Sot shkrimtari Marius Dobrescu drejton revistën "Prietenul albanezului/ Miku i shqiptarit" që botohet në Bukuresht dhe është autor i shumë librave dedikuar Shqipërisë. Këto ditë të para të korrikut ai është përsëri në Shqipëri. Intervista e mëposhtme është marrë gjatë aktivitetit në MHK, në nderim të poetit Cezar Ivanescu.

- Z. Dobresku, ju takojmë përsëri në Tiranë. Cili është motivi i ardhjes suaj, kësaj here?

- Ardhja ime në Shqipëri ka dy motive: e para, ekspozita kushtuar poetit Cezar Ivanescu, poet që ka lidhje të forta me Shqipërinë. Nëna e tij ka qenë shqiptare. Shkaku i dytë është vlerësimi që më bëri Bashkia e Korçës, e cila më dorëzoi emblemen e Artë të Qytetit. ("Emblema e Artë e Qytetit" iu dha Z. Marius Dobrescu, personaliteti i njohur i kulturës rumune, i cili ka dhënë kontributin e tij në prezantimin e kulturës shqiptare). Përfitova nga rasti për të ardhur edhe një herë në Shqipëri. Unë e kam zakon që të vij thuajse çdo vit në Shqipëri dhe këtë e konsideroj

Duhen investime më të mëdha për letërsinë shqipe!

"Fatkeqësisht letërsia shqipe nuk njihet në Rumani. Përveç Ismail Kadaresë, si dhe disa poetëve që kanë dalë në shtypin letrar, letërsia shqipe nuk është e njohur. Ka poetë shumë të mirë në Rumani, edhe sot, jo vetëm klasikë. Por ka pak përkthyes. Sikurse ka edhe shkrimtarë shqiptarë, përveç Kadaresë, që mund të përktheheshin në Rumani. Ajo që mungon është përkthyesi"

një gjë shumë të mirë sepse takoj shokët e shkollës, punës, personalitete të ndryshme.

Le të ndalemi pak te poeti Cezar Ivanescu? Pse ky aktivitet tani në Shqipëri?

- Organizimi i këtij aktiviteti është thjesht nga fakti se ky projekt u aprovua nga Instituti i Kulturës Rumune. Ishte një projekt i ideuar kohë më parë por që tani gjeti mundësinë për t'u realizuar. Me këtë rast erdhën me mua edhe dy piktorë të njohur rumunë, Aurelia Calinescu dhe Ion Draghici, që kanë punuar me Cezar Ivaneskun, i kanë ilustruar veprën dhe e kanë cilësuar atë në një nivel shumë të lartë. Kanë qenë miq të poetit. Nuk ka ndonjë rast të jashtëzakonshëm për të nderuar poetin, por mjafton fakti se poeti ka gjak shqiptari. Pastaj ai ka mundur të vijë në Tiranë, dy herë, një herë në 1978 dhe herën e dytë



në promovimin e librit të tij në TKOB, "Lojë dashurie", botim I "Ora"-s, përkthyer nga Luan Topçiu, në vitin 2008.

- A mendoni se mund të ndihet pak borxhli shteti shqiptar në mosvlerësimin e personalitetit të Cezar Ivaneskut? A duhet bërë më shumë në vlerësimin edhe të figurave të tjera botërore që kanë kontribut e gjak shqiptar?

- Fatkeqësisht poeti ka ardhur shumë vonë në Shqipëri. Publiku, shteti shqiptar, nuk e njeh Cezar Ivaneskun. Përveç përkthimit të Luan Topçiu, nuk ka asnjë vëllim tjetër të tij në shqip. Prandaj them se është i panjohur dhe shteti nuk e ka vlerësuar. Fatkeqësisht, pas kthimit në Rumani, ai ndërroi jetë. Por nuk është kurrë vonë për të bërë një vlerësim të tij. Duhet bërë ndonjë propozim edhe nga ana jonë.

- Diçka më shumë për vlerësimin tuaj në Korçë? Ju a jeni i ndjerë i vlerësuar nga shteti shqiptar?

- Mund të them se po. Në vitin 2006 kam marrë "Pendën e argjente" nga MKRS. Pastaj, në vitin 2012, mora "Medaljen e Mirënjohjes" nga presidenti Nishani, kurse tani mora "Emblemën e Artë të Qytetit" në Korçë. Mund të them se shteti shqiptar më ka shpërblyer më shumë sesa shteti rumun.

- Ju jeni një përkthyes i sukseshëm dhe mjaft i njohur i letërsisë shqipe në Rumani. Si e shikoni zhvillimin e letërsisë shqipe sot?

- Fatkeqësisht letërsia shqipe nuk njihet në Rumani. Përveç Ismail Kadaresë, si dhe disa poetëve që kanë dalë në shtypin letrar, letërsia shqipe nuk është e njohur. I kam propozuar shtëpisë botuese "Humanitas",

atje ku botoj unë, edhe një shkrimtar tjetër shqiptar, është një romancier shumë i mirë. E kam fjalën për Fatos Kongolin. Shpresoj se pas Kadaresë, të cilit i kam përkthyer thuajse gjithë veprën e tij, Fatos Kongoli do të jetë autori i dytë. Mendoj se është shkrimtar i mirë, e kam lexuar, ka sukses jashtë, e kam njohur personalisht dhe e vlerësoj shumë.

- A është bërë sa duhet si për letërsinë shqiptare në Rumani, ashtu edhe për letërsinë rumune në Shqipëri? A ka mundësi më shumë?

- Sapo u takova me Ermir Nikën nga MK dhe ai më tha të njëjtën gjë, që është përkthyer shumë pak nga poezia rumune në Shqipëri. Ka poetë shumë të mirë në Rumani, edhe sot, jo vetëm klasikë. Por ka pak përkthyes. Sikurse ka edhe shkrimtarë shqiptarë, përveç Kadaresë, që mund të përktheheshin në Rumani. Ajo që mungon është përkthyesi. Ka shumë pak përkthyes nga shqipja në Rumanisht, por dhe nga rumanishtja në shqip. Me vdekjen e Dionis Bubanit që përkthente shumë bukur dhe ishte shumë i vlerësuar edhe në Rumani, nuk ka përkthyes tjetër.

- Çfarë shikoni ju si të përbashkët mes dy letërsive apo mes dy shoqërive tona ballkanike?

- Kemi gjëra të përbashkëta, si dy shoqëri të dala nga komunizmi, nga diktatura. Ka të përbashkëta, por ka edhe gjëra të ndryshme. Në letërsi,

në Rumani, ka poetë shumë të mirë, pra ndihemi të fortë, ndërsa ju keni epërsi në prozë, në romane. Si poet unë vlerësoj Dritëro Agollin, por është i panjohur në Rumani. Kam përkthyer disa vjersha të tij, janë cilësuar shumë të mira, por prapë një vëllim i tij është shumë pak. Është problem se kur janë të panjohur në tregun rumun, nuk e marrin përsipër shtëpitë botuese.

Edhe diçka tjetër, dua të them. Unë erdha në fillim të viteve 2000 në Shqipëri me iniciativën e MK, që në nëntor të vitit 2002 u organizua në takim me përkthyes të letërsisë shqipe nëpër botë. Takova këtu përkthyes nga Gjermania, nga Polonia, Spanja, etj, në kaudër të Panairit të Librit. U bënë debate interesante, dolën edhe në televizione e gazeta, u njohëm me letërsinë shqipe drejtpërdrejt, me shkrimtarë dhe veprat e tyre. Kam konstastuar se vitet e fundit, ose ministria nuk ka më interes, ose nuk ka para. Ajo iniciativë ka qenë shumë e mirë. Kemi takuar edhe vetë Kadarenë. Atëherë kam njohur shkrimtarë të tjerë si Kongoli, Stefan Capaliku. etj. **-Cili do ishte mesazhi juaj?**

Mesazhi im i parë është për Ministrinë e Kulturës. MK ka një faqe web-i, një inventar të autorëve, veprave dhe përkthyesve që janë jashtë shtetit. Mendoj se kjo është shumë pak. Duhen investime më të mëdha për letërsinë shqipe!

Shuhet “babai” i pikturës shqiptare, Vilson Kilica


Ka ndërruar jetë në moshën 84-vjeçare një nga baballarët e pikturës shqiptare, “Piktori i Popullit” Vilson Kilica. Ai u nda nga jeta mëngjesin e sotëm pas një sëmundjeje të rëndë, por la pas një vepër të madhe për artin...

Ka ndërruar jetë në moshën 84-vjeçare një nga baballarët e pikturës shqiptare, “Piktori i Popullit” Vilson Kilica. Ai u nda nga jeta mëngjesin e sotëm pas një sëmundjeje të rëndë, por la pas një vepër të madhe për artin shqiptar.

Kilica ishte ndër krijuesit më të rëndësishëm të pikturës shqiptare dhe kontributi i tij është i pazëvendësueshëm. Mbi 100 vepra të Vilson Kilicës janë ekspozuar në vende të ndryshme të botës e shumë të tjera në institucione brenda vendit.

Krijimet e tij fillojnë nga viti 1950 e deri në ditët tona sidomos për periudhën e gjatë të viteve të diktaturës komuniste në Shqipëri. Mbas studimeve në Akademinë e Artit në Leningrad, Vilson Kilica kthehet në atdhe për

të dhënë një kontribut të rëndësishëm në kulturën dhe artin shqiptar. Me personin e tij lidhet krijimi i Akademisë së Arteve. Si drejtori i parë i kësaj Akademie, Vilson Kilica ka pasur rolin kryesor si organizator dhe përpilues i strukturës pedagogjike. Kilica përcillet sot për në banesën e fundit nga miq, të afërm, familjarë e personalitete të ndryshme të kulturës dhe artit në vend.



Maks Velo në Wendy Museum të LA

Maks Velo është i pari piktor shqiptar veprat e të cilit janë pjesë e një koleksioni në një muzeu ndërkombëtar. Wendy Museum në Los Angeles ka ciklin e tij të vizatimeve në harkun kohor 1989-93, “Kujtesa të dhomës së burgut të Spaçit”, vepra që shprehin dhimbje e hakmarrje njëkohësisht.

“Kjo ishte si një rezervuar i dhimbjes, i një gjëje të tmerrshme, që unë doja ta nxirra, e nxorra dhe pastaj shpëtova. Plotësova një koleksion prej 30 veprash që ia dhashë dhuratë muzeut”, shprehet Velo. Kjo ishte një mënyrë e artistit për t’u hakmarrë. Ai donte t’i tregonte botës çfarë ishte diktatura në Shqipëri. “Kjo ishte mënyra ime e hakmarrjes. Doja të tregoja ja çfarë jeni ju, ja çfarë jeni para botës dhe këtë e arrita”, thotë artisti, shkruan top channel.

Kjo punë është një kujtesë historike, që përcjell dhunën psikologjike dhe fizike deri në shpërfytyrim nga pushteti shtypës. Por sipas Donna Stein, drejtores së Wendy Museum, këto vizatime janë



një mënyrë sesi publiku amerikan duhet të kuptojë një dëshmi që i vlen historisë. “Se unë doja ta bëja gjithmonë Enver Hoxhën, por ishte problemi si do ta bëja. Ai arriti

të jetë mbreti i vdekjes, i së keqes, i krimin e i Spaçit. Këtë i dhash, i dhash kurorën e vdekjes, skeptrin dhe tmerrin e qënies së një kufome”, tregon më tej Velo.

U shënua tetë vjetori i Beratit në UNESCO


Në këtë shënim, janë nxjerrë edhe konkluzat mbi angazhimet e institucioneve për përmbytjen e listës së rekomandimeve nga ICOMOS dhe UNESCO, ku mes të tjerash është thënë se akoma ka për t’u bërë.

Specialistë të trashëgimisë kulturore, drejtues institucionesh vendore të artit, kreerë të bashkisë, përfaqësues të Shoqatës së Artizanatit “Margarita” dhe Organizatës “Njerez dhe Ide”, janë bërë bashkë sot në qytetin e Beratit për të shënuar tetë vjetorin e përfshirjes së këtij qyteti në listën e pasurisë së njerëzimit, UNESCO. Gjatë një dite të mbushur me aktivitete kulturore është kërkuar më shumë bashkëpunim mes institucioneve dhe qytetarëve, me qëllim ruajtjen, konservimin dhe ekspozimin e vlerave të trashëgimisë kulturore. Drejtuesit e institucioneve vendore të trashëgimisë, kulturës dhe bashkisë kanë dalë në një konferencë të përbashkët për shtyp ku kanë analizuar punën e bërë deri tani dhe projektet për të ardhmen në mbrojtjen e vlerave të trashëguara.

Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare, Eugen Kallfani, u shpreh në fjalën e tij se për të plotësuar listën e rekomandimeve të lëna nga ICOMOS dhe UNESCO ka filluar

puna me një analizë të detajuar të gjithë situatës për sa i përket ruajtjes së vlerave në lagjet simbolike. Sipas tij, ndonëse raportet e UNESCO-s për Beratin kanë qenë pozitive, veçanërisht për sa i përket ndalimit të ndërtimeve në zonat historike, ka ende shumë për të bërë, kryesisht në masat e marra kundër fatkeqësive natyrore si zjarret dhe përmbytjet. Më pas në Qendrën Historike, në “Teqenë e Helvetive”,

Drejtorja Rajonale e Kulturës Kombëtare organizoi një takim bashkëbisedues mbi mundësitë e bashkëpunimit, shqetësimeve të qytetarëve dhe informimit të banorëve të Qendrës Historike. Takimi u hap me një prezantim të drejtorit të DRKK Eugen Kallfani mbi punën, ecurinë dhe problematikën që hasen në punën e përditshme për mirëmbajtjen dhe transmetimin e vlerave kulturore.



Filmi “Pikturat e papërfunduara” do të përfshijë edhe aktorë shqiptarë

Në këtë film me skenar dhe regji të Valton Jakupit, i cili do të xhirohet në Francë, përpos aktorëve francezë do të përfshijë edhe aktorë shqiptarë. Vetë Jakupi ka thënë se filmi ka për bosht rrëfimin për fëmijët refugjatë.

Para pak ditësh shkruajti për flimin “Ushitari i humbur”, me regji të regjisorit francez Murphy François i cili e sjellë regjisorin shqiptar Valton Jakupi, përveç si asistent regjie edhe aktor i rolit kryesor të këtij filmi. Por ky nuk do të jetë projekti i vetëm që Valton Jakupi do të bashkëpunojë me francezët, siç tregoi ai për KultPlus, tanimë veç ka gati filmin e dytë që do ta bëjë me aktorë nga Franca, film ky që do të vijë me skenar e regji të vet Valton Jakupit.

“Për momentin i kemi dy projekte në bashkëpunim me francezët, ku filmi tjetër që do të jetë me skenar e regji timen, është filmi “Pikturat e papërfunduara”, ku xhirimet e tij pritet ti nisim në shtator, bashkë me të njëjtin produksion International Film Europe London-Swiss”, tha tutje ai duke treguar edhe për atë se çfarë do të përmbajë filmi.

“Pikturat e papërfunduara”, ka të bëjë me temën e refugjatëve dhe mbrojtjen e fëmijëve refugjatë. Në këtë film krahas aktorëve francez do të inkuadroj edhe tre ose katër aktorë shqiptarë, që për momentin nuk mund ti bëjmë të ditur”, pohoi Valton Jakupi. Seti i fotografive testuese për filmin “Pikturat e papërfunduara”, sipas regjisorit, janë kryer në Atelienë Naski Art, dhe tashmë i janë prezantuar komisionit për përcaktimin e roleve.

Krejt për fund, rrëfimin e tij Valton Jakupi e përfundoi duke thënë se pas angazhimeve të mëdha në filmat francezë dhe amerikanë, asnjëherë nuk do ta braktisë misionin e tij që të zhvillojë edhe projekte filmike në gjuhën shqipe.

“Këtë kontributin tim ia dhurojë gjithë popullit shqiptarë, edhe pse jam në shërbim të kinematografisë evropiane, asnjëherë se harroj kombin tim dhe në secilin vend do ta kem pas vetes”, përfundoi regjisorin Valton Jakupi.




Monger sërisht në TKOBAP

Kjo fundjave do te mireprese në datat 09 dhe 10 Korrik 2016, Ora 20.00 në TKOBAP shfaqjen e fundit per kete sezon.

TKOBAP, ka zgjedhur për të rivendosur ne skene një nga shfaqjet më të bukura që ka patur këtë sezon, baletin Monger nga koreografi i njohur izraelit Barak Marshall.

Objektivat më të rëndësishme që TKOBAP ka patur në fillim të këtij 3-vjeçari po realizohet me sukses dhe është pikerisht krijimi i një teatri të repertorit, i cili lejon që të jenë gjithmone aty për publikun për të ofruar artin tone...

Monger u ngjiti premier në skenën e TKOBAP në Maj të këtij viti dhe u vlerësua për levizjet, teatralitetin, muziken e bukur dhe të vecantë me motive nga xhipsi e ballkanase deri tek ajo klasike me Handel e Verdi. Një balet që krijoi një atmosferë shumë të bukur edhe për trupën e baletit, e cila e vlerësoi shumë bashkëpunimin me një nga koreografet më të njohur në të gjithë botën për baletin modern dhe që sic shprehet edhe Drejtori i TKOBAP Ilir Korni: është krenari që ta kemi në repertorin e teatrit tone.



HERONJTË

HISTORITË
E BURRAVE DHE GRAVE MË TË FAMSHME

Simon Sebag Montefiore

55

JEWS IN THE CENTRAL STATE ARCHIVE

Prof. Dr. NEVILA NIKA
LILJANA VORPSI



ARCHIVAL GUIDE BOOK

55

*"Një shprehje e fuqisë, por jo një parim i të vërtetë, është të Shpirtit...
Një pengesë për fuqinë... Nëse s'është kështu, çfarë do bëjë, me dashuri, një lexues me sy për të kështjellur."
Gimerson*

Simon Sebag Montefiore

Një natë dimri

55

Simon Sebag
MONTEFIORE

STALINI I RI

Fitues i çmimit "Costa Biography Award", 2007



55
Ishqipe
Botuese